

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6087
E premte, 14 gusht 2020
çmimi 0.40 €

Dështon tryeza e liderëve shqiptarë, Ahmeti: Me kanun, në konak hyhet nga porta, e jo nga dritarja I FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NUK PRITET TË KETË ZGJERIM TË KOALICIONIT QEVERISËS NË KOSOVË I FAQE 4-5

PDK-ja REFUZON KOALICIONIN E MADH



Partia Demokratike e Kosovës u ka dhënë fund spekulimeve se mund t'i bashkohet koalicionit qeverisës. Kjo parti ka bërë me dije se asnjë kalkulim i partive në pushtet nuk mund t'i

shmangë zgjedhjet nacionale për vitin e ardhshëm. Edhe njohësit e rrethanave politike kanë bërë me dije për "Epokën e re" se kjo qeveri nuk mund të jetë gjatë në pushtet. Ndërsa

zyrtarët e koalicionit qeverisës vazhdojnë të mendojnë se për t'u përballur me sfidat që e presin, Kosovës i duhet një koalicion i madh, i cili duhet t'i ketë të paktën 61 vota shqiptare

OPINION

ÇFARË ËSHTË SHQIPËRIA E MADHE DHE CILI ËSHTË INTERESI AMERIKAN PËR SHQIPTARËT? F. 11

Shkruan:
Spartak NGJELA



AKTUALE

AAK-ja KËRKON KOMPENSIMIN E TË PLAGOSURVE NË DEMONSTRATA F. 4

LV-ja FTON VELIUN NË INTERPELANCË PËR HYRJEN E XHANDARËVE SERBË NË KARAÇEVË F. 5

EKONOMI

KUVENDI SOT SHQYRTON PROJEKTLIGJIN PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE F. 8

PROTESTOJNË PUNËTORËT E "IMN KOSOVA", KËRKOJNË 20-PËRQINDËSHIN E PRIVATIZIMIT F. 9

RRITET PËR 50 PËR QIND SHUMA E GARANCIVE KREDITORE NË KOSOVË F. 9

SPORT

VERË ME BEREQET PËR 'DARDANËT' F. 16



PËRFAQËSUESIT E POPULLIT NUK E VOTOJNË PROJEKTLIGJIN PËR VLERAT E UÇK-së



Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë dështuar të enjten ta votojnë në lexim të parë Projektligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për të kanë votuar vetëm 36 deputetë, ndërsa në votim nuk kanë marrë pjesë deputetët e LV-së dhe të LDK-së. Dalja e tyre jashtë ka

nxitur reagimin e veteranëve të UÇK-së ndaj këtyre dy subjekteve politike. Ndërsa deputeti i PDK-së, Gazmend Bytyçi, i cili e ka iniciuar këtë projektligj, e ka quajtur të çuditshme sjelljen e deputetëve të këtyre dy partive ndaj projektligjit i cili është kritikuar nga ndërkombëtarët I FAQE 2

KOSOVË: TETË TË VDEKUR, 205 TË SHËRUAR DHE 193 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË I FAQE 7

AMBULANCA PËR CORONAVIRUS

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Meta kthen për rishqyrtim Ligjin e pronave të paluajtshme të shtetit



TIRANË, 13 GUSHT (ER) - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ka kthyer në Kuvend për rishqyrtim Ligjin nr. 111/2020 për disa shtesa në Ligjin nr. 8743, datë 22.2.2001, për pronat e paluajtshme të shtetit, të ndryshuar. “Ky ligj, në mënyrë të pashpjeguar dhe arsyetuar, është shqyrtuar me urgjencë brenda 7 ditëve nga Kuvendi. Nisma që paraqitet si ndërhyrje në legjislacionin në fuqi për forcimin e mekanizmave ligjorë për mbrojtjen e intere-

sit dhe pasurisë publike, në fakt rrezikon të shkaktojë një problematikë në raport me të drejtën e gëzimit dhe posedimit të pronës sipas titujve të fituar të pronësisë. E vetmja çështje që duket se ka marrë vëmendjen më të madhe të qeverisë dhe Kuvendit është rregullimi i marrëdhënieve juridike që shteti ka lidhur apo do të mund të lidhë me persona të tretë për përdorimin e pasurisë pronë publike, tashmë edhe pa një afat të përcaktuar”, ka njoftuar

Presidenca shqiptare. Në këtë njoftim është thënë se ndërhyrjet e miratuara me Ligjin nr. 111/2020 bëjnë që askush të mos jetë tashmë në gjendje ta përcaktojë, të paktën ligjërisht, nëse një pasuri, pronë private e ndodhur në afërsi të bregdetit dhe e përfutur me një nga mënyrat e ligjshme të fitimit të pronësisë, sipas Ligjit nr. 7501/1911 për tokën, legjislacionit për kthimin dhe kompensimin e pronës, legjislacionit të privatizimit, apo një vendimi gjyqësor.

Zoran Zaev nominohet për kryeministër të Maqedonisë së Veriut



kanë dobësuar BDI-në në këto bisedime, dhe kjo dukshëm po shihet”, ka deklaruar kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti. LSDM-ja e Zoran Zaevit në zgjedhjet e 15 korrikut ka fituar 46 ulëse në kuvend, BDI-ja 15,

opozita shqiptare 12, PDSH-ja 1. Në rast se brenda 20 ditëve LSDM-ja nuk arrin ta formojë qeverinë, atëherë mandati duhet t'i kalojë partisë së dytë fituese, VMRO-DPMNE-së, e cila ka 44 ulëse në Kuvend.

Dështon tryeza e liderëve shqiptarë, Ahmeti: Me kanun, në konak hyhet nga porta, e jo nga dritarja

SHKUP, 13 GUSHT (ER) - Ka dështuar tryeza e përbashkët e liderëve shqiptarë, e cila ishte ftuar nga lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti. Ai kishte ftuar në një takim të gjithë kryetarët e partive politike të shqiptarëve në Maqedoninë Veriut, duke përfshirë Zijadin Selën, Afrim Gashin, Menduh Thaçin e Bilall Kasami, por asnjëri nga ata nuk i është përgjigjur ftesës së Ahmetit.

Pas dështimit të kësaj tryeze, ka reaguar Ahmeti, i cili ka thënë se me kanun, në konak hyhet nga porta, e jo nga dritarja. “E ne, si fitues dhe prijës të këtij procesi, nuk i ftuam sot të na mbështesin, por u thamë ejani me ne të ecim bashkë, ejani me ne t'i ndajmë përgjegjësitë, ejani me ne t'i nderojmë shqiptarët dhe të gjithë të tjerët”, ka shkruar Ahmeti në llogarinë vet në “Facebook”.



SHKUP, 13 GUSHT - Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, ka nominuar kryetarin e Lidhjes Social-Demokrate (LSDM), Zoran Zaevin, kandidat për kryeministër të ri të këtij vendi. Në bazë të Kushtetutës, Zoran Zaev ka afat prej 20 ditëve që ta paraqesë përbërjen e re qeveritare për votim në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut. Pas marrjes së mandatit, Zaev nuk bëri të ditur nëse ka arritur të sigurojë 61 votat e nevojshme, por as t'i qartësojë pozicionet me Bashkimin Demokratik për Integrim (BDI) që, gjithashtu, kërkon postin e kryeministrit. “Ne po i vazhdojmë bisedimet. Kemi sukses në shumë aspekte, por kemi edhe çështje të tjera që nuk i kemi mbyllur e që janë çështje serioze. Nuk do të jap detaje pasi nuk do të ishte në interes të flasim pa pasur diçka konkrete. Është me rëndësi që sa më parë të formohet qeveria, të cilën jam i gatshëm ta drejtoj

në katër vjetët e ardhshme”, ka deklaruar Zaevi, duke theksuar nevojën që në plan të parë të të gjitha partive të jenë interesat e qytetarëve dhe koncepti “një shoqëri për të gjithë”. Ndërsa kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, ditën e enjte kishte ftuar në takim kryetarët e partive të tjera shqiptare, kryetarin e Aleancës për Shqiptarët, Zijadin Sela, të Alternativës, Afrim Gashi, të Lëvizjes Besa, Bilall Kasami dhe kryetarin e Partisë Demokratike Shqiptare, Menduh Thaçi, për të biseduar për zhvillimet politike, synimet në mandatin e ri, por asnjë prej tyre nuk i është përgjigjur ftesës së Ahmetit, pasi kishin kërkuar agjendë të qartë se çfarë dëshiron kryetari i BDI-së nga një takim i tillë. “Jam thellësisht i zhgënjyer për mosardhjen e tyre në një ditë historike si kjo e Marrëveshjes së Ohrit. Do të doja që si parti t'i falënderoja për arritjet që janë bërë gjatë kësaj kohe... dhe të marrim përgjegjësi të

përbashkëta për të gjitha detyrimet e tjera për të cilat pritët zgjidhje nga ne”, ka deklaruar Ahmeti. Sa iu përket bisedimeve për qeverinë e re, edhe Ahmeti nuk ka dhënë detaje, duke theksuar se gjithçka do të dihet në ditët në vijim. “Unë nuk dua të paragjykoj negociatat dhe epilogun e bisedimeve. Për çdo zhvillim opinioni do të njoftohet. BDI-ja vepron me kokë të ftohtë dhe me zemër zjarri. Gjithçka që do të ndërmarrim do të jetë në dobi të të gjithëve”, ka deklaruar Ahmeti. Kryetari i BDI-së foli edhe për bisedimet që kanë pasur partitë e tjera shqiptare me kryetarin e LSDM-së që, sipas tij, kanë dëmtuar pozicionin e BDI-së në bisedimet e mëtejme për koalicionin qeverisës. “Unë nuk e di se çfarë kanë biseduar, por e di se BDI-ja nuk është forcë që mund të anashkalohet me një takim të tillë. Sigurisht se takimet e tilla, qoftë publike apo pas perdeve, dhe ato goditje e

PKD-ja dhe veteranët e UÇK-së reagojnë për mosvotimin e Projektligjit për mbrojtjen e vlerave të luftës

Përfaqësuesit e popullit nuk e votojnë Projektligjin për vlerat e UÇK-së



Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë dështuar të enjten ta votojnë në lexim të parë Projektligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për të kanë votuar vetëm 36 deputetë, ndërsa në votim nuk kanë marrë pjesë deputetët e LV-së dhe të LDK-së. Dalja e tyre jashtë ka nxitur reagimin e veteranëve të UÇK-së ndaj këtyre dy subjekteve politike. Ndërsa deputeti i PKD-së, Gazmend Bytyqi, i cili e ka iniciuar këtë projektligj, e ka quajtur të çuditshme sjelljen e deputetëve të këtyre dy partive ndaj projektligjit i cili është kritikuar nga ndërkombëtarët

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 13 GUSHT - Deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk i kanë dhanë mbështetje në leximin e parë Projektligjit për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për këtë projektligj kanë votuar 35 deputetë, një votë ishte kundër dhe asnjë abstenim. Në votim nuk kanë marrë pjesë deputetët e LV-së dhe të LDK-së. “Kjo do të thotë që 36 deputetë kanë marrë pjesë në votim”, ka thënë kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, duke shtuar se për shkak të mungesës së kuorumit për votimin e këtij projektligji, i njëjti mund të hidhet në votim në një rast tjetër. Mosmiratimi i këtij projektligji

ka nxitur pakënaqësinë e veteranëve të UÇK-së. Kryetari i OVL-UÇK-së, Hysni Gucati, ka kritikuar ashpër Lëvizjen Vetëvendosje dhe Lidhjen Demokratike të Kosovës, të cilat nuk e kanë votuar projektligjin. Në profilin e vet në “Facebook”, ai ka shkruar se LV-ja dhe LDK-ja për këtë çështje nuk dallojnë nga Lista Serbe. “Skandalet dhe pafytyrësia e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Lëvizjes Vetëvendosje nuk kanë fund. Këto dy subjekte sot treguan se nuk kanë asnjë dallim nga Lista Serbe përderisa nuk votuan projektligjin për vlerat e luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, ka shkruar Gucati. Sipas tij, këto dy parti nuk janë asgjë më shumë, vetëm të mjera dhe frikacake. “Nuk jeni asgjë më shumë,

vetëm se të mjerë dhe frikacakë. Po të mos ishte lufta e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës ju të mjerët nuk do të flisnit shqip. Ju nuk jeni asgjë më shumë, vetëm se frikacakë, që nuk jeni në gjendje të jeni në shërbim të vendit tuaj. Herët ose vonë projektligji për vlerat e luftës do të miratohet, por ju do të mbeten gjithmonë frikacakë dhe të mjerë. Jeni turpi i gjithë Kosovës”, është shprehur ai. Pas dështimit në lexim të parë, ka reaguar edhe deputeti i PKD-së, Gazmend Bytyqi, i cili e ka iniciuar Projektligjin për vlerat e UÇK-së. Në një konferencë për media, ai e ka vlerësuar të çuditshme sjelljen e deputetëve të LV-së dhe LDK-së gjatë seancës së sotshme. “Për mua ka qenë e befasishme dhe e papritur mënyra se si u trajtua pika e parë e rendit të ditës apo

për Ligjin që trajton vlerat e UÇK-së. Ishte e befasishme ajo formë e votimit, sepse që tre muaj kemi diskutuar dhe kemi bashkëbiseduar me të gjitha grupet parlamentare dhe kemi pasur konsensusin politik dhe unitetin që këtë ligj ta trajtojmë në lexim të parë, pastaj shqetësimet t'i adresojmë në lexim të dytë dhe ta përmirësojmë. Edhe më e çuditshme është se si deputetët tanë apo kolegët nuk patën guximin të jenë brenda sallës, madje një pjesë e tyre qëndruan edhe jashtë Kuvendit, ndërsa një pjesë e tyre qëndruan brenda dhe nuk votuan as për, as kundër, as abstenuan”, ka thënë Bytyqi. Ai ka thënë se PKD-ja është e gatshme të bëjë përmirësime në projektligjin i cili është kritikuar nga ndërkombëtarët. “I kuptojmë disa prej shqetësimeve të kolegëve, disa prej shqetësimeve edhe të miqve ndërkombëtarë, por ne i kemi siguruar dhe i sigurojmë që ne jemi të gatshëm që në leximin e dytë, apo brenda kohës ndërmjet leximit të parë dhe të dytë, t'i bëjmë përmirësimet, amendamentet e nevojshme që të votojnë për. E rëndësishme është që qëllimi kryesor i këtij ligji është ta institucionalizojmë luftën e

UÇK-së si vlerë sublimë e vendit tonë dhe arritje e vendit tonë”, ka deklaruar Bytyqi. Përmes një deklarate të përbashkët, organizatat e shoqërisë civile që kryesisht merren me drejtësi tranzicionale i kanë bërë thirrje PKD-së që të tërheqë këtë projektligj. Në deklaratë kërkohet nga deputeti i PKD-së, Gazmend Bytyqi, që si propozues ta tërheqë këtë projektligj, pasi i njëjti, sipas tyre, nuk është në përputhje me të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kushtetutën e Kosovës. “Veçanërisht, projektligji aktual cenon lirinë e shprehjes, ndërsa minon përpjekjet drejt arritjes së drejtësisë për të gjithë viktimat dhe të mbijetuarit nga të gjitha grupet etnike”, është thënë në reagim. Ky projektligj ka nxitur reagime të shumta për shkak se po vlerësohet se mund ta cenojë lirinë e shprehjes si dhe krijon mundësi për të frikësuar dëshmitarë potencialë të proceseve gjyqësore ku përfshihen ish-pjesëtarë të UÇK-së. Projektligji ka disa nene të cilat po i kontestohen. I pari është neni 3 që definon atë se çka është vlerë e luftës, pastaj neni 5 që flet për respektimin e vlerave

Nuk pritet të ketë zgjerim të koalicionit qeverisës në Kosovë

PDK-ja refuzon ko

Partia Demokratike e Kosovës u ka dhënë fund spekulimeve se mund t'i bashkohet koalicionit qeverisës. Kjo parti ka bërë me dije se asnjë kalkulim i partive në pushtet nuk mund t'i shmangë zgjedhjet nacionale për vitin e ardhshëm. Edhe njohësit e rrethanave politike kanë bërë me dije për "Epokën e re" se kjo qeveri nuk mund të jetë gjatë në pushtet. Ndërsa zyrtarët e koalicionit qeverisës vazhdojnë të mendojnë se për t'u përballur me sfidat që e presin, Kosovës i duhet një koalicion i madh, i cili duhet t'i ketë të paktën 61 vota shqiptare



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 13 GUSHT - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka hedhur poshtë pretendimet e parterëve të koalicionit qeverisës se ajo mund të bëhet pjesë e qeverisë aktuale. Zyrtarët e partive në pushtet dhe disa zyrtarë të PDK-së kanë shprehur nevojën e zgjerimit të koalicionit për të pasur Kosova një qeveri më stabile për t'u përballur me sfidat që e presin vendin, por PDK-ja ka konfirmuar qëndrimin e saj se do të jetë opozitë deri në fund të mandatit. Nënkrjetari i Kuvendit nga radhët e PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se asnjë kalkulim i koalicionit aktual qeverisës nuk mund t'i shmangë zgjedhjet vitin e ardhshëm. "Kalkulimet e partive të koalicionit qeverisës, me kërkesë për ta shmangur mundësinë e zgjedhjeve parlamentare vitin e ardhshëm, tregojnë shumë për

gjendjen e mjerë në të cilën ndodhen ato, por edhe janë dëshmi e mosbesimit të thellë që kanë qytetarët ndaj tyre. Çfarëdo diskutimi për postin e presidentit të shtetit, duke e pasur presidentin me mandat të plotë dhe në detyrë për së paku edhe shtatë muaj, është joetik, thënë më së buti. Aq më shumë, nëse pjesë e këtyre planeve është edhe çështja e akuzave potenciale nga Dhomat e Specializuara", ka shkruar Krasniqi në profilin e vet në "Facebook".

Ai i ka ftuar partitë në pushtet që të merren me punët që iu takojnë, duke shtuar se deri tash s'kanë qenë në gjendje ta përmbushin as minimumin e përgjegjësive që i kanë marrë. "Kërkesa jonë për koalicionin qeverisës është që të merret më pak me fjalë e më shumë me punë, sepse deri tash s'ka qenë në gjendje ta përmbushë as minimumin e përgjegjësive që i ka marrë. PDK-ja ka shprehur

qëndrimet dhe vizionin e vet që nga 6 tetori dhe deri tash asgjë nuk ka ndryshuar", është shprehur Krasniqi.

Ndërsa analisti politik Faton Abdullahu ka bërë me dije se qeveria aktuale po e pranon mospunësin e saj duke bërë oferta për partnerë të ri në qeveri. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se me

këto oferta për partitë e tjera, qeveria Hoti po përpiqet t'i amortizojë kritikën e ndryshme. "A po rrëshqet kjo qeveri në atë gjendje ku çfarëdo tjetër është më e mirë sesa të vazhdohet kështu? Jo zakonisht këtu mospunësin ajo po e pranon duke bërë oferta për partnerë të ri në qeveri. Në anën tjetër, për çudi vazhdon të thotë se po bënë

punë shumë të mirë. Duket se e vetmja mundësi që kjo qeveri të mbetet në pushtet dhe të vazhdojë kështu si është, është që vetë ajo të ngjallë shpresa dhe hap mundësi për klane, parti dhe individë se ata mund të vijnë në pushtet përmes ofertave të saj", ka vlerësuar Abdullahu. Sipas tij, kjo qeveri çdo ditë e më tepër po e tregon brishtësinë e saj.

AAK-ja kërkon kompensimin e të plagosurve në demonstrata

PRISHTINË, 13 GUSHT - Deputetët e AAK-së të enjten kanë kërkuar kompensimin e të plagosurve në demonstratat para luftës. Këtë nismë ligjore e kanë prezantuar deputetja Teuta Haxhiu dhe deputeti Bekë Berisha në një konferencë për media. Ata kanë kërkuar që në Ligjin për statusin e të drejtave të dëshmorit, invalidëve veteranëve dhe stafit të UÇK-së, të përfshihen edhe ata që janë plagosur gjatë demonstratave para luftës. Haxhiu ka thënë se numri i këtyre personave që po kërkojnë trajtim të barabartë është 120. "Jemi këtu që t'ju prezantojmë një nismë ligjore, që e kam marrë me përkrahje të plotë të grupit parlamentar dhe deputetëve të

tjerë lidhur me plotësimin e Ligjit për statusin e të drejtave të dëshmorit, invalidëve veteranëve dhe stafit të UÇK-së. Pra, kërkesa është e Shoqatës së të Plagosurve. Pra, po flasim për të plagosurit që neve nuk na u kanë prezantuar në numër të madh, jo më i madh se 120 dhe ata kërkojnë trajtim të barabartë që janë plagosur gjatë demonstratave të ndryshme që kanë ndodhur në vend. Ne kërkojmë një trajtim të barabartë të tyre", ka thënë Haxhiu.

Kurse deputeti Bekë Berisha ka thënë se ky ndryshim-plotësim i ligjit është shumë i nevojshëm për njerëzit që kanë bërë rezistencë në periudha të ndryshme para lufte për lirinë e vendit.



alicionin e madh



“Gjithnjë e më shumë, me brishtësinë dhe përçarjen e saj, kjo qeveri po dëshmon se çdo opsion tjetër është më i mundshëm sesa vazhdimi i saj kështu si është. Menaxhimi i pandemisë, sidomos fillimi i vitit të ri shkollor, do të duhej të ishte prioritet mbi prioritetet për këtë qeveri por, nuk janë”, është shprehur ai, duke shtuar se pikat

e dobëta të kësaj qeveri janë menaxhimi i pandemisë dhe dialogu me Serbinë. “S’ka asgjë të re nga qeveria aktuale që e demanton të vjetrën se ShBA-ja nuk është e përfshirë në dialogun Kosovë - Serbi në Bruksel. Me oferta të reja për parti, klane dhe grupe të ndryshme që ato të bëhen pjesë e qeverisë Hoti po mundohet edhe t’i amortizojë kritikën e ndryshme, sidomos ato mbi menaxhimin e pandemisë dhe dialogut me Serbinë”, ka vlerësuar Abdullahu.

Edhe politologu Belul Beqaj ka bërë me dije se qeveria aktuale nuk do të jetë edhe shumë gjatë në pushtet. Sipas tij, sa më shumë që të zgjatë kjo qeveri aq më shumë do të rritet pakënaqësia e qytetarëve. “Sa më shumë ta vazhdojë punën kjo qeveri aq më shumë do ta ngrehë pezmin e pakënaqësisë dhe revoltës qytetare e cila vetëm sa do të ashpërsohet nëse zgjerohet koalicioni qeverisës. Ana e mirë e kësaj zgjidhje të keqe do të ishte zhveshja e motiveve të partnerëve përfitues të cilët në zgjedhjet e radhës do të ndëshkohen nga votuesit”, ka thënë ai.

Beqaj ka deklaruar se zgjedhjet e reja do të mund të shkaktohen më së largu deri në vjeshtë të këtij viti. “Kjo qeveri do ta kryejë rolin e ‘stafet mbajtjes’ deri në zgjedhjet e lira që do të shkaktohen më së largu në vjeshtë, kur duhet të krijohet një qeveri legjitime dhe me mbështetje serioze të brendshme dhe ndërkombëtare. Qeveria e re do të angazhohet për zgjidhje të marrëveshjes me Serbinë brenda kufijve ekzistues duke gjetur kualitetin e ri mes shumicës dhe pakicës në Kosovë

bazuar në të drejtat universale”, ka thënë Beqaj.

Kosovës i duhet një qeveri me 61 vota shqiptare

Që nga publikimi i propozimaktakuzës për presidentin Hashim Thaçi dhe liderin PDK-së, Kadri Veseli nga Gjykata Speciale, LDK-ja, AAK-ja dhe Nisma Socialdemokrate kanë shprehur interesin e tyre për zgjerim të koalicionit qeverisës. Për këtë skenar kanë qenë edhe disa zyrtarë të PDK-së.

Anëtari i Kryesisë i PDK-së, Xhavit Haliti, ka bërë me dije se për t’u përballur Kosova me të gjitha sfidat që e presin, vendi duhet të ketë një koalicion të madh me politikanë e ekspertë të mirë e të përgjegjshëm. “Pyetja që shtrohet shpesh këto ditë, për sa i përket koalicionit qeverisës: të hyjë PDK-ja ose jo? Edhe në këtë rast unë e kam mendimin tim. Kosova është në udhëkryq të madh për shumë arsye. Po i numëroj disa, pa bërë kategorizim sa i përket rëndësisë së tyre: pandemia Covid-19, dialogu me Serbinë, ndalimi i njohjeve të shtetit të Kosovës, tërheqja e njohjeve të shtetit të Kosovës, Gjykata Speciale. Shtu këtu edhe ekonominë e dobët, arsimimin që lë për të dëshiruar, shëndetësinë, papunësinë, korrupsionin, nepotizmin, organet e sigurisë, integritimin në institucionet ndërkombëtare, aleancat strategjike me ShBA-në, BE-në, Britaninë e Madhe etj., politika e jashtme... që të mos i numëroj të gjitha me radhë. Të gjitha këto çështje kërkojnë politikëbërje të përgjegjshme

shtetërore dhe jo individë apo koalicion të brishtë si ky që e kemi”, ka deklaruar Haliti.

Në profilin e vet në “Facebook”, ai ka shkruar se partitë duhet të heqin dorë nga interesat e ngushta. “Duke besuar në fuqinë e PDK-së, tek ekspertët dhe te politikanët e saj, mendoj se duhet bashkuar (sipas një marrëveshjeje) së pari me LDK-në, edhe me partitë e tjera për ta qeverisur vendin, për t’u përballur me çështjet që duhet t’i zgjedhim. Prandaj edhe po kërkoj që të lihen interesat personale për interesin e vendit dhe të të gjithë qytetarëve”, ka shkruar Haliti. Megjithatë, ai ka deklaruar se do t’i respektojë vendimet e partisë për këtë çështje.

Edhe kryetari i Këshillit Kombëtar i Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, ka bërë me dije për “Epokën e re” se në këtë situatë kur Kosova po përballlet me sfida të shumta, qeverisë së vendit i duhen 61 vota të partive shqiptare. Ai ka vlerësuar se me një shumicë të tillë Kosova do të përballlej më lehtë me Gjykatën Speciale, pandeminë dhe dialogun me Serbinë. “Ajo që mendoj se i duhet Qeverisë së Kosovës në një situatë të tillë, është se qeveria duhet t’i ketë 61 vota të partive shqiptare. Por, për këtë duhet të vendosë partia që e ka kryeministrin. Në një situatë të tillë, Kosova do të përballlej më lehtë me Gjykatën Speciale, pandeminë dhe dialogun me Serbinë”, ka thënë Krasniqi. Edhe lideri i LDK-së, Isa Mustafa dhe ai i AAK-së, Ramush Haradinaj, janë shprehur të gatshëm për të diskutuar me PDK-në për zgjerim të koalicionit qeverisës.

LDK-ja dhe AAK-ja ende s’kanë diskutuar për çështjen e presidentit

Ndonëse LDK-ja dhe AAK-ja nuk kanë folur për çështjen e presidentit, lideri i kësaj të fundit, Ramush Haradinaj, mund të jetë kandidat për president të Kosovës. Pas mbledhjes së Këshillit Drejtues të kësaj partie, ai ka thënë se ky mekanizëm i partisë e ka autorizuar të flasë për këtë çështje. “Falënderoj Këshillin Drejtues për besimin dhe autorizimin që më dha, që në emër të Aleancës t’i zhvilloj bisedimet eventuale për rikonfigurimin e qeverisë, përfshirë këtu edhe çështjen e presidentit. Besimin që unë të jem kandidat për president, nëse kjo diskutohet në bazë të Kushtetutës, e konsideroj si përgjegjësi të lartë dhe nder të veçantë”, është shprehur Haradinaj. Por zyrtarët e LDK-së kanë deklaruar se çështja e presidentit nuk është në rend të ditës. Nën kryetari i LDK, Lutfi Haziri, ka thënë se deri më tani partnerët e koalicionit qeverisës nuk kanë diskutuar për çështjen e zgjedhjes së presidentit të Kosovës. “Derisa e kemi këtë gjendje nuk kemi zhvillim tjetër politik. Nuk e kemi parë të arsyeshme të flasim për çështjen e presidentit. Tek fundit, në afatin kushtetues presidenti e ka mandatin e vet. Nëse pretendimet e Prokurorit të Specializuar konfirmohen nga ana e gjykatës të rastit, atëherë LDK-ja bisedon me partnerët dhe partitë e tjera politike”, ka thënë Haziri.

LV-ja fton Veliun në interpelancë për hyrjen e xhandarëve serbë në Karaçevë

PRISHTINË, 13 GUSHT (ER) - Lëvizja Vetëvendosje ka njoftuar se ka ftuar në interpelancë ministrin e Punëve të Brendshme (MPB), Agim Veliu, në lidhje me hyrjen e xhandarëve serbë në Karaçevë të Kamenicës. Kjo lëvizje ka theksuar se një veprim i tillë tregon se sa e papërgjegjshme është qeveria e drejtuar nga Avdullah Hoti. “Vetëpërgjegjësi që po bën Qeveria e Kosovës nga përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore për t’i kontrolluar kufijtë dhe integritetin territorial dhe për t’i mbrojtur qytetarët është i papranueshëm dhe dëmton edhe më shumë pozicionin e Kosovës. Kjo sjellje e papërgjegjshme sikur ajo pjesë

nuk është brenda territorit të Republikës së Kosovës vetëm sa nxitë ndërhyrjet e Serbisë. Sot nënkryetarja e Lëvizjes, njëherësh deputetja Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, në emër të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje ka paraqitur lëndën që thërret në interpelancë ministrin e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, Agim Veliu, për çështjen e patrullimit të pjesëtarëve të uniformuar të Republikës së Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës, respektivisht në fshatin Karaçevë të Komunës së Kamenicës”, është thënë në njoftimin e Vetëvendosjes.



KFOR-i dhe Policia e Kosovës planifikojnë veprimtari operacionale të përbashkëta në zonën e Kamenicës

PRISHTINË, 13 GUSHT - Komanda rajonale e KFOR-it në lindje ka njoftuar të enjten se në bashkëpunim me Policinë Kufitare në Kosovë ka nisur planifikimet për veprimtari operacionale të përbashkëta në zonën e Kamenicës. Përmes një komunikate për media është bërë njoftuar se ky vendim është marrë pas një samiti teknik të nivelit të lartë që është organizuar një ditë më parë mes shefit të operacioneve të misionit të KFOR-it, drejtorit të Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj dhe zyrtarëve të tjerë. “Në atë rast të dyja palët shprehën kënaqësi të ndërsjellë për nivelin e bashkëpunimit të zhvilluar deri më tani në fushën e sigurisë dhe u angazhuan për forcimin e mëtejshëm të tij përmes një mekanizmi të përmirësuar javor që do të lejojë një rritje të patrullave të përbashkëta të Policisë së Kosovës dhe KFOR-it në zonë të Kamenicës”, është

thënë në komunikatë.

KFOR-i, misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, ka njoftuar më 7 gusht se në Komunën e Kamenicës kanë zhvilluar një patrullë të sinkronizuar me Forcat e Armatosura serbe, “përgjatë vijës kufitare administrative, në afërsi të fshatit Hodonoc”. Po ashtu, zyrtarët e KFOR-it kanë thënë se në mënyrë rutinore kryejnë patrullime të tilla përgjatë vijës kufitare që shtrihet rreth 350 kilometra, mirëpo kjo vijë nuk është e shënjuar dhe e përcaktuar mirë. Ndërsa zyrtarët qeveritarë në Kosovë e kanë interpretuar në disa mënyra këtë patrullim. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Qeverinë e Kosovës, Meliza Haradinaj-Stublla, pati thënë se ngjarja e 7 gushtit nuk rezulton të jetë patrullim i sinkronizuar, por patrullim i përbashkët mes KFOR-it dhe Serbisë. Sipas saj, për këtë gjë askush nuk ka mandat e as autorizim.



Ndërkohë, ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Agim Veliu, ka deklaruar më 8 gusht se gjatë një takimi me

komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Michele Risi, është njoftuar se hyrja e forcave të xhandarmërisë serbe

në territorin e Kosovës ka qenë vetëm një patrullim i përbashkët i këtyre forcave me pjesëtarët e KFOR-it.

Qeveria diskuton për skenarët për fillimin e vitit të ri shkollor



PRISHTINË, 13 GUSHT (ER) - Kryeministri Avdullah Hoti ka treguar se sot kabineti qeveritar ka diskutuar për tre skenarët e fillimit të vitit të ri shkollor. Në profilin e vet në “Facebook”, ai ka shkruar se ministri Likaj, në takimin virtual, i ka njoftuar në lidhje me mbarëvajtjen e sistemit arsimor në Republikën e Kosovës. Ai ka thënë se janë pajtuar për hartimin e protokolleve të thjeshta dhe të kuptueshme se si do të veprohet në cilëndo situatë të paraparë. “Me ministrin e Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, sot kemi

folur për tre skenarët e fillimit të vitit të ri shkollor. Ministri Likaj në takim virtual na njoftoi në lidhje me mbarëvajtjen e sistemit arsimor në Republikën e Kosovës në kushte pandemie, me ç’rast u pajtuam për hartimin e protokolleve të thjeshta dhe të kuptueshme se si do të veprohet në cilëndo situatë të paraparë. Protokoli do të shërbejë si udhëzues i qartë për DKA-të, drejtorët e shkollave, nxënësit, prindërit dhe opinionin se si duhet të veprohet në cilëndo situatë që kushtëzohet nga virusi Covid-19”, ka shkruar Hoti.

Dumoshi: Kam ndërmarrë nismën për ndërtimin e kullës së komandantit Sali Çekaj

PRISHTINË, 13 GUSHT (ER) - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka bërë me dije se ka ndërmarrë nismën për ndërtimin e kullës së komandantit Sali Çekaj. Këtë lajm ajo e ka bërë me dije nëpërmjet një statusi në llogarinë e vet në “Facebook”, ku ka thënë se Sali Çekaj ishte personalitet i jashtëzakonshëm, intelektual, njeri i pendës dhe pushkës. “Sot bëra

homazhe para shtatores së Heroit Sali Çekaj. Dëshiroj t’i informoj qytetarët e Deçanit dhe më gjerë, se kam marrë nismën për ndërtimin e kullës së komandantit Sali Çekaj. Sali Çekaj ishte personalitet i jashtëzakonshëm, intelektual, njeri i pendës dhe pushkës. Ai dha kontribut të jashtëzakonshëm për lirinë e vendit dhe u kthye nga mërgimi për të rënë heroik-

isht në fushën e nderit në betejën e Koshares. Personalitetet si Sali Çekaj nuk harrohen kurrë dhe kanë zënë vend në historinë e re të Kosovës. Çdo gur i ndërtuar në kullën e Sali Çekajt është dëshmi e luftës për lirinë e Kosovës, ku gjeneratat e reja do të përkulen para jetës dhe veprës së tij. Lavdi jetës dhe veprës së heroit Sali Çekaj!”, ka shkruar Dumoshi.



Kosovë: Tetë të vdekur, 205 të shëruar dhe 193 raste të reja me Covid në Kosovë



Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 491 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren prej të cilëve kanë rezultuar 193 raste pozitive me Covid. Po ashtu, brenda 24 orëve janë raportuar tetë raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitivë si dhe janë shëruar 205 persona

komuna Klinë 4 raste, komuna Skenderaj 4 raste, komuna Suharekë 4 raste, komuna Deçan 3 raste, komuna Lipjan 3 raste, komuna Malishevë 3 raste, komuna Dragash 2 raste, komuna Han i Elezit 2 raste, komuna Kaçanik 2 raste, komuna Obiliq 2 raste, komuna Shtime 2 raste dhe me nga një rast komunat Graçanicë, Kamenicë dhe Istog”, ka njoftuar ky institut.

Ndërsa ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, të enjten ka pritur në takim ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj, me të cilin ka biseduar për situatën e përgjithshme në vend, me theks të veçantë për zbatimin e masave dhe aktivitetet e koordinuara nga Grupi Ndër-Institucional për Menaxhimin e Incidenteve. Të dy ministrat u kanë bërë thirrje qytetarëve që t'i respektojnë vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe masat e IKShPK-së për paran-

rastet pozitive janë nga Prishtina, Peja, Gjilani etj. “Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 56 raste, komuna Pejë 18 raste, komuna Gjilan 14 raste, komuna Vushtrri 13 raste, komuna Mitrovicë 11 raste, komuna Prizren 11 raste, komuna Podujevë 10 raste, komuna Gjakovë 8 raste, komuna Drenas 5 raste, komuna Viti 5 raste, komuna Ferizaj 4 raste, komuna Fushë Kosovë 4 raste,

Në spitalet e Kosovës, 448 pacientë të shtrirë me Covid-19

Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet e përgjithshme po trajtohen 589 pacientë, prej të cilëve 448 kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Në njoftimin për media të ShSKUK-së është treguar se 375 persona i janë nënshtruar oksigjeno-terapisë, kurse 41 pacientë janë në gjendje të rëndë shëndetësore. Në klinikat e QKUK-së janë të hospitalizuar 223 pacientë, 193 të konfirmuar pozitivë me virusin Korona, gjersa 127 janë me oksigjenoterapi. Spitalet e përgjithshme po ofrojnë shërbime mjekësore për 366 pacientë, prej tyre 255 pozitivë, ndërkaq 248 persona i janë nënshtruar oksigjenoterapisë.

Licencohen edhe tetë laboratorë privatë për testime për Covid-19

Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se janë licencuar edhe tetë laboratorë privatë për kryerje të testeve serologjike për Sars-COV2. Bordi për licencim të institucioneve shëndetësore private i MSh-së ka miratuar gjithsej kërkesën e 46 institucioneve private për testime për koronavirusin e ri. Në listën e parë ishin 29 laboratorë të licencuar, prej tyre 27 për testime serologjike e dy për testime PCR. Dje janë licencuar edhe nëntë të tjerë për testime serologjike. Ndërsa sot janë licencuar tetë. Nga tetë laboratorët e licencuar nga dy janë në Prishtinë e Ferizaj, ndërsa nga një në Vushtrri, Mitrovicë, Lipjan e Deçan.

dalimin e përhapjes së virusit Covid-19, në mënyrë që të ruhet shëndeti publik. Gjithashtu, ministri Zemaj të enjten ka vizituar Komunën e Gjakovës, ku është pritur nga kryetari i kësaj komune, Ardian Gjini, me të cilin kanë qëndruar edhe në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF).

Kryeministri kritikon inspektorët, janë selektivë në raste të caktuara

Kryeministri Avdullah Hoti është ankuar në punën e inspektorëve në terren që po inspektojnë zbatimin e masave anti-Covid. Ai ka treguar se me shqetësim ka pranuar informata se në raste të caktuara, inspektorët janë selektivë ndaj atyre që nuk respektojnë masat. Në profilin e vet në “Facebook”, ai ka shkruar se kjo

nuk do të tolerohet. “Sot, në konsultimin që kisha me policinë, inspektoratin sanitar, Ministrinë e Shëndetësisë, institucionet e tjera ndihmese dhe nivelin komunal, jam informuar për aktivitetet në terren në mbikëqyrje të zbatimit të masave. I falënderova për angazhimin dhe kërkova të zbatohen masat pa pardon. Shumë shpejt do ta rrisim prapë numrin e inspektorëve sanitarë. Nuk do të ketë tolerancë ndaj shkelësve të masave që po rrezikojnë jetën e qytetarëve, as ndaj atyre që nuk respektojnë inspektoratin dhe policinë duke i penguar në kryerjen e detyrës. Me shqetësim pranova informatën se në raste të caktuara, inspektorët janë selektivë ndaj atyre që nuk respektojnë masat. Kjo nuk do të tolerohet. Nesër do të kem raport me shkrim nga institucionet përkatëse”, ka shkruar Hoti.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 GUSHT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se brenda 24 orëve të fundit kanë ndërruar jetë tetë persona si pasojë e Covid-19 dhe janë paraqitur 193 raste të reja. Ky institut ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar edhe 205 pacientë të cilët kanë qenë të infektuar me virusin “Korona”. “Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 491 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren prej të cilëve rezultojnë 193 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 8 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 10 988 raste nga 42 627 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 373 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 205 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 6 616 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 999”, ka njoftuar IKShPK-ja, duke bërë me dije se

Selimi: Themelimi i Gjykatës Komerciale fuqizon sistemin e drejtësisë

Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, gjatë takimit me përfaqësuesit e odave ekonomike, ka thënë se kjo ministri së bashku me partnerët strategjikë, ShBA-në dhe të tjerët, ka ndërmarrë iniciativë për ta finalizuar Ligjin për Gjykatën Komerciale, e cila, sipas tij, do t'i trajtojë çështjet e kontesteve komerciale. Në këtë kontekst, ai ka thënë se kjo gjykatë do ta forcojë edhe më tutje sistemin e drejtësisë



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 GUSHT - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, është takuar të enjten me përfaqësues të odave ekonomike në Kosovë. Gjatë këtij takimi, ministri Selimi dhe përfaqësuesit e odave ekonomike kanë diskutuar për rimëkëmbjen ekonomike gjatë dhe pas pandemisë Covid-19, si dhe për themelimin e Gjykatës Komerciale, me ç'rast është theksuar rëndësia që kjo gjykatë

do të sjellë për çdo biznes dhe investitor në Kosovë. Kështu është thënë në komunikatën për media dërguar nga Ministria e Drejtësisë. Ministri Selimi ka vënë në dukje se Ministria e Drejtësisë së bashku me partnerët strategjikë, sidomos ShBA-në, ka ndërmarrë iniciativë për ta finalizuar Ligjin për Gjykatën Komerciale që, sipas tij, do t'i trajtojë çështjet e kontesteve komerciale. "Çështja e Gjykatës Komerciale ka dalë nga rishikimi funksional i sektorit të

sundimit të ligjit dhe është parë si shumë e nevojshme për t'iu qasur në mënyrë më serioze kontesteve komerciale, pra kontesteve në ekonomi. Artikulimi në një shtyllë i çështjeve komerciale i zgjidhë ato me ekspertizë, ul riskun e të bërit biznes, riskun e kontesteve, riskun e fitimit sepse mbrohet me një gjykatë e cila merret ekskluzivisht me këtë çështje", ka thënë Selimi.

Sipas ministrit Selimi, themelimi i Gjykatës Komerciale do ta fuqizojë sistemin e drejtësisë sepse duke zgjidhur kontestet në ekonomi, vendi ynë do të ofrojë siguri për çdo biznes dhe investitor në Kosovë. "Përfitimi kryesor i themelimit të Gjykatës është se të gjitha kontestet ndërmjet bizneseve, por edhe të gjithë afaristët do të kenë një adresë. Kërkesë të veçantë kam pasur

që të ekzistojë një panel i veçantë për investime direkte të huaja në mënyrë që kjo të ofrojë siguri për investitorët e jashtëm", është shprehur Selimi. Ndërsa përfaqësuesit e odave ekonomike e kanë falënderuar ministrin Selimi për bashkëpunim, duke e vlerësuar të rëndësishëm themelimin sa më të shpejtë të Gjykatës Komerciale.

Mazreku: Të hiqen të gjitha kushtëzimet antikushtetuese për regjistrimin e veturave

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Sami Mazreku, e ka mirëpritur vendimin e marrë nga kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, për suspendimin e pagesës së tatimit në pronë deri më 31 gusht i cili ka kushtëzuar regjistrimin e veturave. Mazreku ka thënë për gazetën "Epoka e re" se i është drejtuar Avokatit të Popullit për t'i hequr kushtëzimet për regjistrim të veturave në mënyrë që, sipas tij, t'u lehtësohet qytetarëve barra e pagesave, në mënyrë që të bie edhe numri i veturave të paregjistruara



është për t'u përshëndetur dhe duhet të ndiqet edhe nga komunat e tjera për shkak të pandemisë, në mënyrë që qytetarët mos të mblidhen pranë zyrave komunale", ka thënë Mazreku.

Më tutje, ai ka thënë se, përpos kushtëzimeve për taksa komunale, duhet të hiqet edhe kushtëzimi për gjokat e trafikut me rastin e regjistrimit të makinave. "Përfundimisht, në mënyrë që ky proces të jetë më i lehtë, e që Ministria e Punëve të Brendshme e ka vendosur një afat se deri kur duhet të regjistrohen këto automjete, do të ishte mirë që edhe MPB-ja ta pezullojë nenin ku specifikon që gjatë regjistrimit të automjeteve qytetarët duhet t'i paguajnë fillimisht gjokat e trafikut. Sigurisht që kërkesa jonë nuk është që gjokat të mos paguhet, por mos të lidhen me regjistrimin e automjeteve dhe kjo përfundimisht do ta lehtësojë regjistrimin e automjeteve", ka thënë Mazreku.

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 GUSHT - Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Sami Mazreku, e ka mirëpritur vendimin e kryetarit të Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, për suspendim të pagesës së tatimit në pronë deri më 31 gusht. Një tatim i tillë ka qenë kushtëzim për regjistrimin e

veturave. Ai ka thënë se shembulli i Ahmetit duhet të ndiqet edhe nga komunat e tjera. Mazreku ka thënë për gazetën "Epoka e re" se i është drejtuar Avokatit të Popullit për t'i hequr kushtëzimet për regjistrim të veturave në mënyrë që, sipas tij, t'u lehtësohet qytetarëve barra e pagesave dhe të bie numri i veturave të paregjistruara. "Njoftimi nga kryetari i

Prishtinës, Shpend Ahmeti, për pezullim të kushtëzimit për pagesën e tatimit në pronë me rastin e regjistrimit të veturave, është vendim më se i mirëpritur. Në dy vjetët e fundit si shoqatë kemi kërkuar që kushtëzimet për regjistrimin e automjeteve të hiqen. Një ndër kushtëzimet është edhe vërtetimi për tatimin në pronë. Për të njëjtin temë unë si drejtor kam ushtruar dhe ankesë pranë Avokatit të

Popullit, ku kam argumentuar pse ky kushtëzim është kundërkushtetues dhe fillimisht kam pranuar një njoftim për pranueshmërisë, pasi sigurisht kur rasti ka bazë për hetim të mëtutjeshëm avokati e lëshon një njoftim për pranueshmëri dhe besoj që shumë shpejt do të dilet me rekomandimi që këto kushtëzime duhet të hiqen. Mirëpo, sërish e ceku se iniciativa e kryetarit të Prishtinës

Kuvendi sot shqyrton Projektligjin për rimëkëmbjen ekonomike

Prishtinë, 13 gusht (ER) - Kryesia e Kuvendit e Republikës së Kosovës ka mbajtur të mërkurën një mbledhje në mënyrë elektronike (virtuale), nën drejtimin e kryetares Vjosa Osmani, ka vendosur që sot (e premte) deputetët ta shqyrtojnë për herë të parë

Projektligjin nr. 07/L-016 për rimëkëmbjen ekonomike Covid-19. Po ashtu, sot do të shqyrtohet në lexim të dytë Projektligji për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës. Gjithashtu, kryesia ka vendosur që në këtë seancë të shqyr-

tohet propozimi i deputetit të LDK-së, Haxhi Avdyli, mbështetur edhe nga 41 deputetë të tjerë nënshkrues, për formimin e komisionit hetimor parlamentar mbi procesin e licencimit, operimit, mbikëqyrjes dhe aplikimit për leje të hidrocentraleve në Republikën e Kosovës.



Protestojnë punëtorët e 'IMN Kosova', kërkojnë 20-përqindëshin e privatizimit

Punëtorët e ndërmarrjes "IMN Kosova" kanë protestuar të enjten para ndërtesës së qeverisë për mospagesën e 20-përqindëshit e cila u takon pas privatizimit të kësaj ndërmarrje. Në mungesë të kryeministrit Hoti, ata janë takuar me Ahmet Isufin e AAK-së. Ata kanë thënë se për ta marrë 20-përqindëshin e privatizimit duhet të ketë nënshkrim qeveritar

/Epoka e re/

PRISHTINË, 13 GUSHT - Punëtorët e ndërmarrjes "IMN Kosova" kanë protestuar të enjten para ndërtesës së qeverisë për mospagesën e 20-përqindëshit pas privatizimit të kësaj ndërmarrje. Në vend të kryeministrit Avdullah Hoti, punëtorët e "IMN Kosova" i ka pritur Ahmet Isufi, i cili është pjesë e kabinetit të zëvendëskryeministrit të parë, Besnik Tahiri. Për ta marrë 20-përqindëshin,

Isufi u ka thënë atyre se duhet të presin kthimin e kryeministrit nga izolimi.

Ndërsa Emin Neziri, përfaqësues i protestuesve, pas takimit me Isufin, ka thënë se për t'i realizuar kërkesat e tyre duhet vendim qeveritar, pra për ta marrë 20-përqindëshin duhet nënshkrimi i qeverisë për shpronësim. "U takuam me Ahmet Isufin. Ata na premtojnë që brenda një jave do ta kryejnë këtë punë. 120 punëtorë po presin. Për shkak të shpronësimit nuk po i japin 20 për qind. Një nënshkrim i



qeverisë duhet për shpronësim", ka thënë Idrizi. Kjo deklaratë e tij i ka revoltuar, të cilët nuk janë pajtuar që

në takim i ka pritur Ahmet Isufi, prandaj kanë thënë se nuk presin ndonjë ndihmë. Në anën tjetër, Ismet Hasani,

pjesëmarrës në protestë, ka thënë se qeveritarët po përpiqen të përfitojnë në krah të tyre.

Rritet për 50 për qind shuma e garancive kreditore në Kosovë

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) ka bërë me dije se është rritur për 49.4 për qind shuma aktive e kredive, si dhe për 57.5 për qind është rritur numri i garancive aktive

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 GUSHT - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) ka njoftuar se është rrit-

ur për 49.4 për qind shuma aktive e kredive. Sipas raportit vjetor të FKGK-së, po ashtu ka pasur rritje edhe të numrit të kredive. "Përderisa shumica e vendeve anëtare gjatë vitit të



kaluar vazhduan të kenë norma pozitive të rritjes, në disa tregues rritjet më të larta në përqindje

janë regjistruar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore si: rritja e shumës aktive e garancive 49.4 për qind dhe rritja e numrit të garancive aktive 57.5 për qind", ka njoftuar FKGK-ja. Sipas këtij njoftimi, fondi ka treguar se gjatë vitit 2019 organizatat anëtare të Shoqatës Evropiane për Institucionet Garantuese kanë mbështetur bizneset në vlerë prej 38.8 mil-

iardë eurosh për ta mbyllur vitin me një shumë totale të garancive aktive prej 110.7 miliardë eurosh dhe me më shumë se 2.8 milionë biznese të mbështetura. Po sipas këtij njoftimi, FKGK-ja ka arritur mesataren prej 0.7-përqindësh të prodhimit të brendshëm bruto të portofolit të vendeve anëtare, për t'i kaluar skemat garantuese të shteteve të Ballkanit Perëndimor.



Mustafa thotë se është dyfishuar buxheti i pagesave direkte për bujqit

PRISHTINË, 13 GUSHT (ER) - Ministri i Bujqësisë, Besian Mustafa, ka njoftuar se janë shtuar edhe 26 milionë euro si përkrahje për bujqit në këtë vit. "Të nderuar bujq, sapo dyfishuam buxhetin për pagesat direkte për vitin 2020, me vendim të qeverisë! Këto mjete

do të përdoren për t'i ndihmuar bujqit tanë t'i tejkalojnë sfidat e mungesës së shijës që u shkaktoi Covid-19 sivjet, për ta rritur prodhimin bujqësor vendor, për ta rritur punësimin në zonat rurale, për ta zvogëluar importin e produkteve bujqësore dhe për ta rritur sigurinë e

ushqimit që konsumojnë familjet tona", është shprehur Mustafa. Ai ka thënë se do t'i subvencionojnë normat e interesit të kredive bujqësore për disa sektorë të caktuar të bujqësisë. Kjo shtesë shkon plus buxhetit të rregullt prej 53 milionëve.

Zgjatet afati për subvencione për fermerët në veri të Kosovës

PRISHTINË, 13 GUSHT (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) ka njoftuar të gjithë fermerët e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Leposaviqit dhe Zubin Potokut, se dosjet e tyre

për aplikim në Programin për pagesa direkte - subvencione 2020 mund t'i dorëzojnë në Zyrën Regjionale në Mitrovicën e Jugut, rruga "Mbretëresha Teutë". "Ministria e Bujqësisë,

Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka vendosur që afati për aplikim për pagesa direkte të zgjatet deri më 28 gusht 2020. Kjo zgjatje është bërë pas kërkesave të fermerëve, Drejtorive Komunale për

Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës, duke ua mundësuar në këtë mënyrë aplikimin të gjithë fermerëve dhe ekonomive bujqësore. Procedurat e aplikimit dhe



dokumentacioni mbetet i njëjtë", ka njoftuar MBPZHR-ja.

Pas më shumë se 50 viteve, fillon zëvendësimi i gypave të azbestit

KAMENICË, 13 GUSHT (ER) - Komuna e Kamenicës, pas më shumë se 50 viteve, ka filluar projektin për zëvendësimin e gypave të azbestit në lagjen "Malësia", "Iliria" dhe në Berivojcë. I pari i kësaj komune, Qëndron Kastrati, e ka konsideruar lajm tejet të mirë ndërrimin e gypave, duke thënë se ky problem i kamotshëm për banorët e Kamenicës e tejet i rrezikshëm për shëndetin e qytetarëve tani po merr fund. "Lajm tejet i mirë për komunën tone. Pas më shumë se 50 viteve, tani po bëjmë zëvendësimin e gypave të azbestit në lagjen 'Malësia', 'Iliria' e në Berivojcë. Ky problem i kamotshëm për

banorët e Kamenicës e tejet i rrezikshëm për shëndetin e qytetarëve tanë tani po merr fund. Sipas këtij projekti që ka vlerën rreth 224 mijë euro, përfshihen edhe kycjet e rrugëve e të shtëpive që ndodhen në këto lokalitete", ka thënë Kastrati.

Kryetari Kastrati ka thënë se ky projekt është i financuar nga qeveria zvicerane dhe ajo e Kosovës. Gypat do të ndërrohen në lagjen "Malësia" në rrugët "Dëshmorët e Kombit" dhe "Besnik Marovca", në lagjen "Iliria" në rrugën "Adem Jashari", në Berivojcë në rrugën "Bajram Curri". Shtrirja e këtyre gypave është rreth 4 900 metra.



Haziri takohet me komandantin e Njesisë Elitare të FSK-së në Gjilan



GJILAN, 13 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur në takim njoftues komandantin e ri të Njesisë Elitare të FSK-së në Gjilan, Albert Kuqi. Me këtë rast, Haziri e ka uruar nënkolonel Kuqin për marrjen e detyrës, derisa ka konfirmuar bashkëpunimin e vazhdueshëm të komunës, në të mirë të sigurisë së qytetarëve të Gjilanit. "E uroj nënkolonelin Albert Kuqi për

marrjen e detyrës së komandantit të Regjimentit të Parë të Forcave Tokësore në Gjilan, që është Njësia Elitare e FFK-së. Ne jemi krenarë me punën dhe profesionalizimin e jashtëzakonshëm të tyre", ka thënë Haziri. Ndërsa komandanti i Regjimentit të Parë të Forcave Tokësore, nënkolonel Albert Kuqi, e ka falënderuar kryetarin Haziri për pritjen dhe ofrimin e bashkëpunimit në çdo kohë të Komunës së Gjilanit.

Fillon asfaltimi i katër rrugëve në Kërvasari të Malishevës



MALISHEVË, 13 GUSHT (ER) - Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës së përgjithshme në Komunën e Malishevës, të enjten ka filluar asfaltimi i katër rrugëve në fshatin Kërvasari. Rrugët që janë duke u asfaltuar lidhin fshatrat Kërvasari dhe Kosterrc. Asfaltimin e rrugëve e ka përcjell-

lë nga afër edhe drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Ahmet Morina. "Sot ka filluar asfaltimi i katër rrugëve në fshatin Kërvasari, të cilat paraprakisht janë hapur dhe përgatitur. Këto katër rrugë kanë një gjatësi prej 1.8 kilometër, ndërsa vizita gjatë asfaltimit kishte për qëllim

inspektimin e cilësisë dhe mënyrës së asfaltimit si dhe respektimit të kriterëve të parapa", ka thënë Morina. Asfaltimi i këtyre rrugëve ka rëndësi të madhe për banorët, pasi mundëson lëvizjen e lirë dhe të lehtë për banorët që jetojnë në këto lagje dhe në fshatin Kërvasari.

Nis zbatimi i masave për krijimin e distancës në lokalet e gastronomisë

MITROVICË, 13 GUSHT (ER) - Zyrtarë komunalë nga Drejtoria e Inspeksionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Kadastrës në Komunën e Mitrovicës, në orët e hershme të mëngjesit të së enjtes kanë përcaktuar pikat shenjzuese për krijimin e hapësirës (distancës) së duhur në mes të tavolinave në lokalet e gastronomisë, sipas vendimit të

marrë nga Shtabi Emergjent Komunal. Me këtë rast, kryetari i komunës, Agim Bahtiri, ka falënderuar për mirëkuptimin e rreguar nga ana e këtyre lokaleve, si dhe ka kërkuar nga ta dhe qytetarët t'i respektojnë në përpikëri këto masa të vendosura nga Shtabi Komunal, pasi prioritet duhet të jetë ruajtja e shëndetit të përgjithshëm.



JO TË GJITHË (MJEKËT) DUHET TË DINË ÇDO GJË, APO TË BËHEN SE DINË ÇDO GJË!



Nga Tefik BEKTESHI

Keqmenaxhimi në QKUK (letër kryeministrit dhe ministrit të Shëndetësisë)

Covid-19 është sëmundje infektive. E shkakton virusi SARS-COV-19. Pandemia është aktuale dhe menaxhimi i saj gjithëpërfshirës është i domosdoshëm. Pasojat e pandemisë, përkatësisht menaxhimin të saj manifestohen në shëndetin e popullatës, ekonomi, gjendjen psikike kolektive dhe individuale... Karakteristikat e virusit duhet t'i studiojë mikrobiologu. Sëmundjen, manifestimet e saj në individ i studion infektologu, ndërsa me parandalim të sëmundjes në popullatë merret epidemiologu. Mjekët e tjerë duhet t'i përcjellin të dhënat aktuale dhe të kujdesen për të sëmurët që i kanë në mbikëqyrje. Pra, jo të gjithë duhet të dinë çdo gjë, apo të bëhen se dinë çdo gjë! Covid-19 është sëmundje infektive dhe duhet shëruar nga infektologu! Në QKUK janë formuar reparte,

edhe klinika të tëra të cilat merren me shërimin e Covid-19. Po në këto Reparte dhe Klinika nuk ka infektolog? Bile nuk e bëjnë as mbikëqyrjen. Të gjithë infektologët janë të përqendruar në Klinikën Infektive me 100 pacientë. Këto reparte nuk kanë protokoll mjekimi të cilin duhet përpiluar (apo aprovuar) nga infektologu - si të diagnostikohen dhe shërohen pacientët nga Covid-19. Kështu virusi u fut në mënyrë aktive kudo në QKUK, në klinikat vitale. Bile edhe aty ku mjekohen kategoritë e popullatës më të ndjeshme, siç janë shtatzënat... Keqmenaxhim i qartë - pëson pacienti, sepse mjekët me specializime të ndryshme thjesht nuk janë kompetentë për mjekim të pacientëve me sëmundje infektive - rrezikojnë pacientin, por edhe veten duke e rritur enormë numrin e punëtorëve shëndetësorë të infektuar. Me këtë uljet potenciali i dëmeve shëndetësore.

Anesteziologët

Anesteziologët janë profesionistë të veçantë, pa ta nuk realizohen operimet që shpëtojnë jetë. Janë të aftësuar që të mbajnë funksionet vitale të njeriut derisa kryhen operimet më të komplikuar. Janë të aftësuar për punë me respirator, makina të cilat

sigurojnë në mënyrë artificiale oksigjenimin kur organizmi vetë nuk është në gjendje të bëjë këtë. Komplikimet më trishtuese të Covid-19 janë në mushkëri dhe atëherë shumë nevojitet respiratori dhe anesteziologu! Për ta bërë punën sa më funksionale, logjika thotë që respiratorët të grumbullohen në një vend në mënyrë që të mbikëqyrin me sa më pak anesteziolog. Anesteziologët, sipas menaxhimit të tanishëm në QKUK, duhet të mbikëqyrin 24 orë dy kujdesë intensive qendrore, respiratorët në objektin e Mjekësisë Sportive, në Klinikën Infektive, Intensiven në Gjinekologji, Kardiokirurgji, si dhe operimet urgjente që bëhen në klinika (Gjinekologji, Oftalmologji, ORL, Kirurgji...), besa janë edhe në komisione të ndryshme. Këta njerëz janë shumë të vlefshëm për sistem shëndetësor, por nuk janë supremenë. Do të lodhen, do t'i humbim! Keqmenaxhim!

Shërbimet vitale

Qendra Klinike Universitare është institucion i vetëm publik ku jepen shërbime të K a r d i o k i r u r g j i s ë , Neurokirurgjisë, Kirurgjisë Vaskulare, Kardiologjisë Invazive... Mjekët dhe infermierët në këto shërbime janë ngushtë të specializuar,


prandaj duhet të ruhen që të jenë të aftë në çdo kohë për dhënie të shërbimit për të cilin janë aftësuar! Jo, kjo nuk përfilltet, dërgohen në reparte ku merren me pacientë të dyshuar apo pacientë të verifikuar që kanë Covid-19! Këto resurse me vite merren me patologji të ngushtë dhe janë më pak kompetentë për mjekimin e pacientëve me simptoma të zakonshme të sëmundjeve infektive: kolla, temperatura, barkqitja... Njëkohësisht uljet potenciali për dhënie të shërbimeve mjekësore të veçanta në QKUK. Kjo vlen edhe për infermierë - transferohen me dhjetëra e qindra nga reparti në repart. Keqmenaxhim!

Në prapavijë interesa të tjera?

Kardiologjia Invazive vitin e kaluar ka realizuar 3 335 koronarografi. Janë realizuar PCI procedura (stentime) te 1638 pacientë, mbi 1 200 në infarkt akut të zemrës. Më së shumti nga ta gjithë institucionet në Ballkan. Në këtë vit është vazhduar trendi i njëjtë sa iu përket rasteve akute. Mjerisht me urdhra të ndryshme janë ndaluar procedurat elektive (jourgjente). Por, duket se në spitale private ato vazhdojnë! Apo me urdhëresa selektive mund të vazhdojnë edhe në QKUK, si tendenca që të

operohen fëmijë nga mjekë të jashtëm që ishte disa ditë më parë. Më tepër, në QKUK hapësira e veprimtimit të Kardiologjisë Invazive zvogëlohet në minimum. Bëhen jofunksionale 17 shtretër të Intensives Kardiologjike. Zvogëlohen edhe kapacitetet e mjekimit intensiv (ku mjekohen pacientë pas traumave në komunikacion, pas komplikimeve të operimeve të rënda, pacientë në komë)... Keqmenaxhim ekstrem! Dhe në fund, a janë zhdukur sëmundjet e tjera - shputa diabetike me gangrenë, karcinoma e gjirit, infarkti i zemrës, pika në tru, sëmundjet psikike... si të trajtohen këta të sëmurë kur janë suprimuar shërbimet jourgjente shëndetësore? Do të pritet në pafundësi për operime të sëmundjeve malinje, vaskulare, intervenimeve kardiologjike në institucione publike apo do të lihet kjo sferë vetëm për institucionet private?! Në gjithë botën analizat dëshmojnë se vdekshmëria nga patologjia jo Covid është rritur, është cenuar gjendja psikike e popullatës dhe individit. Te ne është ndryshe. Zotëri të nderuar, menaxhimi apo keqmenaxhimi i Covid pandemisë në Kosovë është në duart tuaja - aspektet informative, sociale, ekonomike, të sigurisë..., por edhe shëndetësore, e këtu QKUK luan rol qendror.

ÇFARË ËSHTË SHQIPËRIA E MADHE DHE CILI ËSHTË INTERESI AMERIKAN PËR SHQIPTARËT?



Shkruan: Spartak NGJELA

Çfarë është Shqipëria e Madhe, term i kotë, realitet historiko-geografik; është një krijim politik, apo në të përfshihet e gjithë bota shqiptare në Ballkanin Perëndimor? Por, a mund të ketë Shqipëri të Madhe pa shqiptarë? Por, a ka shtet të Ballkanit Perëndimor ku nuk ka treva të gjera shqiptare? Por, a e dini se në Ballkanin Perëndimor - në Shqipëri, në Kosovë, në Mal të Zi, në Maqedoni dhe në Greqi jetojnë rreth dhjetë milionë shqiptarë? Po juve, kjo shpërndarje e shqiptarëve ngushtësisht në këtë zonë, ju duket vetëm një fakt historiko-

geografik i kohës sonë apo, në këtë fenomen shqiptar, luan edhe një interes i madh politik? Po pse nuk është e njohur botërisht si fakt që shqiptarët sot janë 97 për qind proamerikanë? Po mirë, a nuk është fakt historik se ka një konflikt midis Amerikës dhe Rusisë për Ballkanin Perëndimor? Po, atëherë, pse duhet të pyetet gjithmonë: cili është interesi amerikan për Shqipërinë dhe Kosovën, a nuk do t'ju mjaftonte ky fakt? Pse, a nuk dihet si fakt historik se Serbia është "vëllai i vogël" i Rusisë dhe, prandaj, pikërisht për këtë, a nuk e kuptoni dot që në këtë periudhë historike Serbia është e humbur përballë shqiptarëve, sepse ajo ka qenë dhe mbetet pushtuese terriore të gjera shqiptare deri në Nish? Pse, nuk dihet si fakt historik se interesi amerikan për Shqipërinë ka ecur me dokumentacionin

historik, nga presidenti Willson te presidentët Kennedy e Nikson, dhe, nga këta të dy, deri te presidenti Bill Clinton, që krijoi shtetin e ri shqiptar, Kosovën? Pse, edhe tani që dolën dokumentet arkivore nuk e dini që në vitin 1961 presidenti amerikan Xhon Kenedi i tha kryeministrit të Bashkimit Sovjetik, Nikita Hrushov, se "Shqipëria nuk preket"? Pse, ende nuk e dini që ishte presidenti amerikan Riçard Nikson që i kërkoi me presion të hapur presidentit të Jugosllavisë Josip Broz Tito, autonomimë e gjerë të Kosovës, që kjo të ishte si njësi konstituente në kushtetutën e Jugosllavisë të vitit 1974. Po pse, vërtet mendoni se mund të ketë tërheqje amerikane për Kosovën, kur Amerika e njohu atë e para si shtet? Pse, si mendoni ju, një politikë amerikane interesi, që ka nisur si proces politik që në vitin 1919,

do të ndryshojë sot, kur konflikti amarikano rus është më i madh se në vitin 1999, kur NATO bombardoi Serbinë? Dhe, më në fund: përse duhet të jenë dy shtete shqiptare të pavarur në Gadishullin Ilirik, kur këta mund të kenë vullnetin për bashkim, të ndërmarrë me aktin juridik, nëpërmjet referendumeve reciproke? Për të gjitha këto: Përballë një situatë të tillë, pse bërtet me frikë Beogradi dhe Moska se po formohet Shqipëria e Madhe? Po pse, nuk po e sheh Beogradi që shpejt do të dalë një shtet i tretë në Ballkanin Perëndimor dhe mendohet të quhet Ilirida? Pse si mendoni, edhe ju si orekset serbe, që ëndërojnë prishjen e aleancës Amerikë-Shqipëri: nuk e dini ju që gjithçka sot në afirmimin e shtetit të tretë shqiptar dhe pavarësinë e njohur botërisht të Kosovës, është politika e Shtëpisë së Bardhë? E pra, në funksion të

kësaj tabloje të historisë aktuale, si mendoni ju, a duhet të armatosen me ushtri moderne Shqipëria dhe Kosova? Sigurisht që po, sepse shqiptarët sot duhet të tregojnë forcë në fshirjen e plehrave në plehërishtën beogradase, në Prishtinë dhe në Tiranë, dhe të ndërtojnë armatën e tyre moderne Shqipëri-Kosovë, si garantin racional të Shqipërisë Etnike. E pra, për të gjithë këtë tiradë historike që shprehëm, një gjë është realiteti i sotëm historik: nuk ka as Shqipëri të Vogël dhe as Shqipëri të Madhe, por ka vetëm Shqipëri Etnike, që fillon në Prevezë, Kalon në Tiranë, shkon në Shkup dhe në Prishtinë, e që mbaron në Nish. Ky është procesi historik shqiptar, por, se deri ku do të arrijë, askush nuk e di; veçse, ekzistenca e dy shteteve shqiptare në Ballkanin Perëndimor, është një fakt real që na jep të drejtën të arsyetojmë. Kjo është koha jonë. Keni për ta parë.

Ministri i Shëndetësisë: Gjermania në muajt e ardhshëm mund ta ketë vaksinë kundër Covidit

Berlin, 13 gusht - Ministri gjerman i Shëndetësisë, Jens Spahn, ka thënë enjten se ai pret që në muajt e ardhshëm, apo përfundimisht vitin e ardhshëm (2021), të zbulohet një vaksinë ndaj Covid-19. Më 12 gusht Agjencia e Shëndetit Publik në Gjermani fillimisht ka publikuar një raport ku thoshte se në vjeshtë do të ketë një vaksinë por, më pas, dokumenti është fshirë nga faqja e internetit e Institutit Robert Koch (RKI).

Instituti ka thënë se dokumenti nuk ishte i përditësuar dhe ishte botuar gabimisht, raporton

“Reuters”. “Unë jam optimist se në muajt e ardhshëm, sigurisht në vitin e ardhshëm, mund të ketë një vaksinë”, i ka thënë Spahn televizionit gjerman “ZDF”. Spahn nuk ka pranuar të caktojë një muaj specifik në të cilin vaksina do të ishte e gatshme, duke thënë se akoma nuk është e mundur të përcaktohet se sa shpesh njerëzit kanë nevojë të vaksinohen ose sa do të zgjaste imuniteti nga ajo vaksinë. “Por, një gjë që mund të themi është se falë të gjithë neve që punojmë së bashku – studiuesve, shkencëtarëve,

publikut – me siguri do të kemi një vaksinë më shpejt se kurrë më parë në historinë e njerëzimit”, ka thënë ministri gjerman.

Presidenti rus Vladimir Putin ka njoftuar të martën se Rusia është bërë vendi i parë që ka miratuar një vaksinë ndaj Covid-19. Spahn ka përsëritur dyshimet e tij për atë vaksinë, të quajtur “Sputnik V”, duke thënë se kishte relativisht pak të dhëna për të. Të enjten në Gjermani janë regjistruar 1 445 raste të të infektuarve me koronavirusin e ri, duke e çuar numrin e përgjithshëm në 219 964.



Shefi i OKB-së: Pandemia rrezikon paqen në botë

NJU JORK, 13 GUSHT - Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, ka paralajmëruar se pandemia Covid-19 jo vetëm që kërcënon rezultatet në luftimin e varfërisë globale dhe ndërtimin e paqes, por rrezikon t'i përkeqësojë konfliktet ekzistuese dhe të nxisë të reja. Shefi i OKB-së gjatë një takimi të Këshillit të Sigurimit ka folur mbi vështirësitë e ruajtjes së paqes gjatë pandemisë, duke thënë se thirrja e tij më 23 mars për një armëpushim të



menjëhershëm në konflikte në të gjithë botën, bëri që një numër i palëve ndërluftuese pushuan së luftuari. “Megjithatë, për fat të keq, në shumë raste pandemia nuk i shtyu palët t'i pezullojnë armiqësitë ose të bien dakord për një armëpushim të përhershëm”, ka thënë Guterres. Sipas tij, pandemia ka ngritur pyetje në lidhje me efektivitetin e sistemeve shëndetësore, shërbimeve sociale, besimin në institucione dhe sistemet e

qeverisjes. “E gjithë kjo do të thotë që angazhimi ynë për ta mbajtur paqen është më urgjent se kurrë”, ka thënë ai. Në muajin mars Organizata Botërore e Shëndetësisë e ka shpallur pandeminë nga koronavirusi i ri, që e shkakton sëmundjen Covid-19. Rastet e para u paraqitën në Kinë në fund të vitit të kaluar për t'u përhapur shumë shpejt në të gjithë botën. Numri i të infektuarve në botë ka arritur në mbi 20 milionë, ndërsa 749 372 kanë vdekur.

ShBA-ja thotë se Irani konfiskoi një anije në ngushticën e Hormuzit

UASHINGTON, 13 GUSHT - Forcat iraniene konfiskuan për një kohë të shkurtër një anije-cisternë që mbante flamurin e Liberisë, pranë Ngushticës së Hormuzit, ka bërë me dije Komanda Qendrore e Ushtrisë Amerikane (CENTCOM). CENTCOM-i ka publikuar një video bardh e zi, ku tregohet se si forcat speciale zbrisnin shpejt nga një helikopter në anijen-cisternë, pozicioni i fundit i së cilës dukej se ishte

jashtë bregdetit lindor të Emirateve të Bashkuara Arabe afër qytetit të Khorfakkan. Anija ishte mbajtur nga marina iraniene për rreth pesë orë para se të lëshohej më 12 gusht, ka thënë një zyrtar ushtarak amerikan për “Associated Press” në kushte anonimiteti. Nga anija nuk ishte bërë thirrje alarmi para, gjatë dhe pas kapjes së saj, tha zyrtari. Zyrtarët ushtarakë amerikanë nuk kanë ofruar asnjë arsye pse

Irani konfiskoi anijen. Tensionet midis Shteteve të Bashkuara dhe Iranit janë përshkallëzuar qëkur Uashingtoni më 2018 është tërhequr nga një marrëveshje ndërkombëtare bërthamore midis Teheranit dhe fuqive botërore dhe vendosi sanksione të ashpra. ShBA-ja ka thënë se Irani është sponsorizuesi më i madh i terrorizmit në botë dhe se nuk do ta lejojë asnjëherë të posedojë armë bërthamore.



Arrestohen 17 policë në Bosnje e Hercegovinë

SARAJEVË, 13 GUSHT - Prokuroria e Sarajevës ka njoftuar se janë arrestuar 17 policë në operacionin policor “DAR 1”, i cili është kryer në zonën e Kantonit të Sarajevës, Kantonit Zenica-Doboj dhe në Lindje të Sarajevës. Siç raportohet, kjo është përballja më e madhe e Policisë në periudhën e pasluftës në Bosnje dhe Hercegovinë, raporton

“Klix.ba”. 17 oficerëve të policisë së Njësisë së Trafikut të Drejtorisë së Policisë KS MUP dyshohen se kanë kryer më shumë se 100 vepra penale. Prokuroria boshnjake ka njoftuar se policët kanë pranuar dhurata dhe përfitime të tjera duke shpërdoruar pozitën ose autoritetin. Ndryshe, Drejtoria e Policisë e Ministrisë së

Brendshme të Kantonit të Sarajevës ka zhvilluar aksionin nën mbikëqyrjen e Prokurorisë së Kantonit të Sarajevës në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë të MPB-së së Kantonit Zenica-Doboj, Administratën e Policisë Lindore të Sarajevës dhe me ndihmën teknike të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Bosnjës dhe Hercegovinës.

Poezi e dinjitetit mbi gërmadha (mbi krijimtarinë e Xhevdet Bajrajt)

Nga Shqiptar OSEKU

“I lere derën hapur
mbaje dritën ndezur në zemër
që ta di se ku të kthehem”

-Xhevdet Bajraj

Ekziston një teori e diskutueshme, determinizmi nominativ, që thotë se personaliteti i njerëzve sajohet nga emërtimet: nga fjalët me të cilat pagëzohet njeriu a vendi ku është rritur ai. Në rastin e poetit Xhevdet Bajraj, kjo teori mund të jetë dyfish e saktë. Emri i tij, si shumë tjerë të proveniencës muslimane, është nga arabishtja dhe dmth Ekselent, në shqip mbase do të thonim Shkëlqim a Shembullor. Emërtim ky i goditur për një nga poetët më të shkëlqyer të poezisë shqip në Gegërinë e veriut, të lindur më 1960, i cili u shqua që në poezitë e para si zë origjinal, me gjuhë idiosinkretike e mesazh të emancipuar e të ankoruar në rrymat letrare të kohës. Tri përmbledhjet e tij të para në Prishtinë e pushtuar të viteve 1990 ishin kumtare të një pranie të re poetike; përmbledhja e tretë “Emblema e Vdekjes” (1993) fitoi cmimin e librit më të mirë të poezisë nga Shoqata e shkrimtarëve të Kosovës.

Që atëhere, Xhevdet Bajraj ka fituar edhe një sërë cmimesh tjera, një cmim të dytë të Shoqatës së shkrimtarëve më 2000, cmimin ndërkombëtar të Goliardos për poezi më 2004, cmimet Katarina Josipi më 2010 dhe atë të Festivalit Monodrama në Vlorë më 2013 për dramën origjinale në shqip, si dhe cmimin për librin më të mirë në panairin ndërkombëtar të librit në Prishtinë më 2015, midis tjerash. Që nga debimi nga Kosova gjatë luftës më 1999, kur atij iu dha strehë letrare në Meksikë, Xhevdet Bajraj punon si ligjërues me orar të plotë i shkrimit krijues pranë universitetit në Meksiko City, ndërsa poezia e tij është përkthyer në spanjisht, anglisht, gjermanisht, polonisht, hungarisht, serbisht, turqisht, slovenisht, e danisht. Dy botimet i tij të radhës në anglisht, përmbledhja poetike “We Fall Like Children” (2018) dhe drama në vargje “Slaying the Mosquito” (2020), u botuan në përkthim kongjental nga Ani Gjika e Alice Whitmore tek shtëpia botuese amerikane Laertes Books.

Mirëpo, teoria për ndikimin deciziv të emrit mund të argumentohet edhe me vendlindjen e tij parajsore, qytezën e Rahovecit. Banorët e atjeshëm janë shumica pasardhës të shqiptarëve të dëbuar nga cepet më veriore të



Gegërisë, që u shpopulluan nga Serbia më 1878. Ndodhur në mes të artë midis Gjakovës e Prizrenit, Rahoveci ka ngelur në hartë me emërtimin e sajuar sllav Orahovac, shqip: arrishtë, ndonëse atje arrat s’janë kultivuar kurrë. Pokorny Julius, tek

Indogermanisches Etymologisches Wörterbuch (1959) aludon se toka e shndrydhur dhe e lërueshme, në shqip “ara” nga protoindoeuropianishtja “harah”, do t’i kenë dhënë atij vendi emërtimin e vet të parë. Lugina ku ndodhet qyteza e vogël ka kushtet klimatike të Burgundisë franceze, me kombinim të përsosur të diellit e dëborës gjatë vitit. Anët ku është rritur Xhevdet Bajraj janë treva e vetme në tërë Siujdhesën ilirike ku ka gjetur kushtet të rritet si në shtëpi të veten hardhia Pinot noir, ky princ i ndieshëm i Burgundisë. Jo rastësisht, poezia e Xhevdet Bajrajt është e mbarsur me hardhi e musht ujze (rakie) e vere, e histori hijesh që rreken të mbijetojnë emrin e vet, si dhe debimet e vdekjet e veta. Këto kanë stampuar si sigla të fatit edhe vargjet e Xhevdet Bajrajt.

Te ExLibris sot, mund të lexojmë për herë të parë pesë poezi të pabotuara nga Xhevdet Bajraj, pjesë nga një përmbledhje në dorëshkrim. Poezia e mirë nuk sajohet dot në vakuum letrar. Kritiku i vëmendshëm letrar te poezia e Bajrajt i ndien ndikimet e eminecave gri të epokës, Ali Podrimja, Fatos Arapi, Vasko Popa, Danilo Kish, Paul Valery, e Casllav Millosh, por edhe ato të lirikëve latinamerikanë. Vetë Bajraj në një intervistë te Epoka e Re (“Kërkues kokëfortë i parajsës së humbur”, 2019) u referohet autorëve Vincent Huidobro, Juan Rulfo, Juan José Arreola, Carlos Fuentes, e José Emilio Pacheco, si objekt të studimeve të tij. Por lajtmotivi i përsëritur i poezisë së Bajrajt, parajsja e shkretëruar dhe

lufta e qenies njerëzore për një fije dinjitet mbi gërmadha, të kujton edhe antologjinë e Manuel Monteros (1973) mbi poetët latinamerikanë që shkruan për drejtësi sociale, Octavio Paz, Juan Banuelo, e Efrain Huerta meksikanë, Alfonsina Storni e Francisco Urondo argjentianë, César Vallejo e Alejandro Romualdo peruanë, si dhe Gabriela Mistral e Pablo Neruda kilianë. Përmbledhja “Poemas y antipoemas” nga Nicanor Parra (1975) që është përkthyer edhe anglisht është thuase në dialog poetik ndër kohë e hapësirë me opusin e Xhevdet Bajrajt.

KAFE ME NËNËN

Frynte një erë plakë në vjeshtën që po lindte
Është ditëlindja e Irfanit të vrazë para njëzet vjetëve
gjetet e pjergullës biejnë mbi flokët e zbardhura të nënës
ajo nuk sheh mirë
nuk dëgjon mirë
jemi vetëm në mes të parajsës së djegur
derisa ajo në kujtime e saja gatuante bukë për babain tim për mua dhe për veten në Tiranë në banesën e Martin Cukallës
unë pija raki Skrapari me Nexhat Dibrën

Piku një mollë dhe e theu heshtjen
bir
pse disa viteve u mungojnë muajt
Rashë nga qielli i shtatë në këmbë
si mace që i kishte mbetur vetëm një shpirt
Nga molla e rënë doli një krimb si derr i luftës
që e kishte majmur liria

Pije kafënë nënë
pije
janë vite të krimbura

SHTËPITË E BRAKTISURA

Nga dritarja po e shiqonte qytetin
qiellin Zoti para se ta braktiste
e kishte pastruar me fshisë
kështu që ishte i pastër
si loti i një burri
që po fliste me të vdekurit e tij

Sorrat të majmura krockërisnin
në degët e pemëve
nëpër oborret e shtëpive të braktisura
që shumica e banorëve të tyre
kishin ikur
për të mos u kthyer kurrë
dyert i kishin lënë të hapura
çelësat ishin në dyer
dritaret ishin të hapura
që njerëzit nëpër fotografitë e varura në mure
të merrnin frymë

DE NIRON DO TA VRASIN NË FUND TË FILMIT

Mes rrënojave të asaj që dikur
ishte parajsë
bën ftohtë
aq ftohtë sa që edhe pemët
dridhen
i hedhin frutat
Brenda shtëpisë
nëna po vdes ngadal e ulur në kolltuk
duke e shikuar një film me De Niron

Jashtë
bëhet fushatë politike
janë zgjedhjet
votohet për vrasës
(me dhe pa pagesë)
për hajna
për mashtrues
dhe për sklevërit e tyre

Hoxha ia fut ezanit kot
kot bien edhe këmbanat e kishës
Zoti na ka trajtuar me dinjitet
duke na dhënë vullnet të lirë
fuqinë për të marrë vendime
tona

politikanët nuk na japin këtë mundësi

Nënë
De Niron do ta vrasin në fund të filmit
po dal unë ta pi ndonjë birra
të lutem për ne të dy
në njërin nga kafenetë e qytetit
mos ke dert
nuk do të pi nëpër rrugët
që mbajnë emra heronjesh të shpifur
sapo mora vesh që në rrugën
Shën Nëna Terezë
një vrasës e kishte hapur një
tavernë të re
dhe të lutem
lëre derën hapur
mbaje dritën ndezur në zemër
që ta di ku të kthehem

SA HERË E KUJTOJ ATDHEUN

Është ujku i zbutur
brenda një peizazhi të xhunglës
urbane
që pikturoi një fëmijë demon
Sa herë e kujton atdheun e parë
brenda gjoksit të tij
zoti i ujçqerve të zbutur ulërinë

Kjo këtu është një lule egër
e cila edhe pse për herë të parë ka
çelur
këtë e ka bërë në mënyrë të përsosur
Shumë shpesh e kujton atdheun
e kur ndodh kjo
e liron një aromë të përsosur
Ky këtu jam unë
për nevoja të mia e kam zbutur
ujkun
dhe lules ia kam dhënë emrin e nënës sime
Sa herë ta kujtoj atdheun
e ndjej mëngën e majtë të vdekjes
duke ma fshirë gjakun nga hunda

KUR BOTA ISHTE TEPËR E MADHE

Mendonte se i duhej të thoshte
diçka
në letër
diçka të thellë
por nuk i binte asgjë ndërmend

Pas pak iu kujtua koha
kur luante me këmbë të zbathura
në rrugë
deshi të thoshte diçka në lidhje
me këtë
kur bota ishte tepër e madhe
e ëndrrat tepër të vogla
Një sorrë krockati në dritaren e hapur
uni lirik i tij i zgjati duart
dhe ia nxori kokën me rrënjë

Në pasqyrën në mur trupi i tij
dridhej
para se të binte në tokë
pa kokë

Ca muzikantë rruge
e këndonin një këngë që kishte
korr sukses
atë verë
të zymtë / ExLibris.al

E rrallë

Gjarpri me dy koka dhe me helmin më të rrezikshëm

Zvarraniku me gjatësi 11 cm është gjetur jashtë një shtëpie në rrethinën Kalyan të shtetit Maharashtra. Tërheqësi i gjarprit, Prem Aher, ka arritur me zyrtarë të pyjeve që kanë kapur atë dhe e kanë çuar atë në një vend të sigurt, raporton "Southwest News". Vipers Russel ka një nga helmet më të rrezikshëm në botë. Ekipi ka thënë se gjarpri "ishite marrë për kërkime të mëtejshme". "Gjarpri është i gjallë dhe po mbahet në një mjedis të sigurt", ka thënë ekipi që është marrë me këtë gjarpër. Ndërsa zyrтари i Shërbimeve, Pyjore Susanta Nanda, ka thënë se anomalitë e tilla gjenetike



çojnë në nivele të ulëta mbijetese në natyrë. Ai ka shpjeguar pse gjarpri helmues ishte kaq i rrezikshëm për njerëzit. Gjarpri është shumë më i rrezikshëm se shumica e gjarpërinjve helmues sepse ju dëmton edhe nëse i mbijetoni kafshimit fillestar.

BARSOLETA E DITËS



I dashuri: Zëmër, jam çmendur pas teje.
E dashura: Mirë, por rri larg babait tim.
I dashuri: Pse, është i ashpër me djemtë?
E dashura: Jo, por është drejtor i Spitalit Psikiatrik.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje



FOTO E DITES



Qytetarët e Tiranës kanë gjetur si opsion të freskohen në shatërvanët që ndodhen në qendër të qytetit. /LSA/

E jashtëzakonshme

Shkencëtarët zbulojnë tërmetin e çuditshëm "bumerang"

Një tërmet me magnitudë 7.2 ka lëkundur shtëpinë e Rosario Garcia Gonzalez në Baja të Kalifornisë një pasdite pranvere në vitin 2010. Gonzalez, një i moshuar nga komuniteti indigjen Cucapah, më vonë u ka treguar shkencëtarëve se çfarë kishte parë. Teksa tërmeti kishte çarë sipërfaqen e tokës, lart doli një re pluhuri, si një makinë që ecën me shpejtësi në një rrugë të pashtuar. Por makina duket se po shkonte në drejtim të gabuar. Tërmetet zakonisht e çajnë sipërfaqen teksa udhëtojnë në një drejtim të vetëm. Por, sipas Gonzalez, reja e pluhurit po kthehej prapa aty ku ishte origjina e lëkundjes, saktësisht drejtimi i kundërt që shkencëtarët prisnin. Rrëfimi i këtij dëshmitari për një tërmet që kthehej mbrapsht i ka bërë shkencëtarët shumë kureshtarë. Orlando Teran, i cili në atë kohë po punonte për Ph.D e tij në Ensenada Center for Scientific Research and Higher Education, e ka quajtur përshkrimin "spektakolar". Tani një grup ndërkombëtar shkencëtarësh kanë mundur që të kapin një prej këtyre tërmeteve "bumerang" në detaje, duke dokumentuar lëkundjen që shkon me shpejtësi në një drejtim dhe më pas kthehet mbrapsht nga e njëjta rrugë.

 <p>DASHI Moderoni nevojat tuaja dhe vlerësoni të tjerët me mirëkuptim. Për më tepër, nuk është aq e vështirë të bëni të tjerët dhe veten të buzëqeshni.</p>	 <p>DEMI Yjet do kenë një ndikim të madh në sektorin e parave. Në jetën e përditshme yjet ju këshillojnë të shikoni më larg dhe të planifikoni projekte që mund të realizohen.</p>	 <p>BINJAKËT Lëreni veten të joshni, nëse jo nga një dashuri e re, të paktën nga një miqësi e bukur. Kjo është një periudhë e shkëlqyer, në të cilën ia vlen të jetosh jetën.</p>	 <p>GAFORRJA Është dita ideale për të kontaktuar me burimet tuaja të fshehura dhe për të marrë energjinë e nevojshme që do ju ndihmojë të ecni para.</p>	 <p>LUANI Një marrëdhënie e cila deri më tani nuk ka qenë e qartë, do rezultojë mjaft e fortë dhe e kënaqshme. Merr guxim dhe shprehja ndjenjat një personi që ka rëndësi për ju.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Optimizmi, dëshira, një ndjenjë e fortë e kënaqësisë për zbulime të reja dhe për jeta shoqërore do përzihen së bashku në mënyrë të përsosur dhe do ju lehtësojnë të gjitha llojet e veprimtareve.</p>
 <p>PESHORJA Gjeni një mënyrë për të çlodhur trupin tuaj dhe për të larguar mendjen tuaj nga mijëra projekte dhe angazhime. Eksperimentoni me metoda të reja relaksimi.</p>	 <p>AKREPI Kur veproni në harmoni me natyrën tuaj, jeni në gjendje të ndërmerri hapat e nevojshëm për të përparuar me vendosmëri në rrugën e duhur. Yjet këshillojnë të qëndroni me këmbë në tokë.</p>	 <p>SHIGJETARI Ju keni gjetur mbrojtjen e duhur dhe së bashku me partnerin do mbani gjendjen shpirtërore të lartë. Asnjëherë nuk ka qenë më e lehtë se sa kaq për të marrë atë që dëshironi.</p>	 <p>BRICJAPI Ndikimi hënor i ditës së sotme dhe të nesërme sugjeron të kujdeseni për mirëqenien, hobin dhe punët. Mos bëni sporte të ashpra, po stërvitje të vazhdueshme dhe të lehta.</p>	 <p>UJORI Parashikime të mira në sektorin e dashurisë. Dashuria dhe racionaliteti nuk shkojnë së bashku, por sot do bëhet një përjashtim. Mund të funksionojë.</p>	 <p>PESHQIT Familja dhe dashuri ende në plan të parë. Nga mënyra e tyre për t'ju treguar dashuri, ju mësoni të vlerësoni faktet dhe veçanërisht ndjenjat që familja dhe miqtë kanë për ju.</p>

Ed Sheeran do të bëhet së shpejti baba



Ed Sheeran dhe bashkëshortja Cherry Seaborn janë në pritje të fëmijës së tyre të parë. Çifti e ka kaluar pjesën më të madhe të vitit në izolim për shkak të pandemisë, çfarë i ka lejuar ta mbajnë shtatzëninë të fshhtë. Sipas "The Sun", Cherry është në muajt e fundit

të shtatzënisë dhe pritet të lindë në fund të verës. "Izolimi ishte një justifikim shumë i mirë për ta, por duke qenë se dita e lindjes po afrohet, ekzaltimi shtohet dhe çifti ka vendosur t'i tregojë familjes dhe miqve të tyre të afërt", ka shkruar ky medium.

Loredana pozon me orë 12 mijë euro në dorë

mespermes
12.2k followers

View Profile



Loredana sërish shfaqet me aksesore super të shtrenjtë. Veshjet e Loredanës janë gjithmonë me shumë stil dhe në rroba të firmave të njohura botërore. E tillë është paraqitja e saj në një nga fotografitë e fundit në rrjetet

sociale, ku reperja Zefi ka pozuar me një orë dore të markës "Rolex", e cila kushton hiç më pak se 11 653 euro. Është faqja "Mespërmes", ajo e cila ka publikuar një fotografi të repartistes, bashkë me orën e kushtueshme që ajo bart me vetë.



Dua Lipa risjell modën e viteve '60

Vetëm Dua Lipa ia del ta bëjë më seksi pamjen klasike të veshjeve "Chanel". Ylli i muzikës botërore me origjinë shqiptare ka shfaqur pamjen e re të "Instagram"-it që risjell modën e viteve '60, një stil që pritet të

përqafohet nga miliona ndjekës të saj në rrjetet sociale. 24-vjeçarja është shfaqur e veshur me kostum veror në rozë të zbehtë, shirita violetë dhe kopsa ngjyrë ari. Pjesë e pamjes në foto është edhe qenushi i saj Dexter.

Ledina Çelo provokon me një imazh nga shtrati

Këngëtarja e njohur shqiptare Ledina Çelo vazhdon të jetë një ndër emrat shumë të komentuar në mediat rozë. Ajo nuk është aktive për sa iu përket projekteve muzikore, mirëpo aktive është në rrjetet sociale ku publikon imazhe të ndryshme. Ledina, nënë e dy fëmijëve, ka arritur t'i ruajë format trupore dhe duket tejet joshëse. Së fundmi ka provokuar nga shtrati dhe duket tejet joshëse.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**



Verë me bereqet për 'Dardanët'

Disa nga futbollistët e Përfaqësueses së Kosovës kanë ndërruar skuadra e disa të tjerë pritet të ndërrojnë në ditët e ardhshme. Mediat në Itali raportojnë se Vedat Muriqi ka arritur marrëveshje me Lazion, kurse Milot Rashica është në mes të RB Leipzig dhe Aston Villas

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 13 GUSHT - Afati kalimtar i kësaj vere është me bereqet për disa nga lojtarët e Kosovës në futboll. Kapiteni Amir Rrahmani pas një edicioni fantastik me skuadrën Hellas Verona, sezonin e ri do të jetë pjesë e Napolit me të cilën kishte nënshkruar muaj më parë. Ky është hapi më i madh në karrierë për ish-futbollistin e Drenicës, Partizanit dhe Dinamo Zagrebit. Ndërsa muajin e kaluar mesfushori i spikatur Valon Berisha vendosi që karrierën futbollistike ta vazhdojë në Francë, përkatësisht në skuadrën ku luan edhe reprezentuesi tjetër i "dardanëve", Arbër Zeneli në Stade de Reims. Berisha ishte pjesë e Lazios, por në gjashtë muajt e fundit ishte i huazuar te

Fortuna Dusseldorf në Bundesliga. Mesfushori besohet se i ka kushtuar skuadrës franceze pesë milionë euro. Lëvizje në këtë afat kalimtar ka bërë edhe mbrojtësi i majtë i Kosovës, Leart Paqarada. Ky i fundit u largua nga Sandhausen dhe nënshkroi kontratë deri në vitin 2023 me St. Paulin. Njëri prej sulmuesve më të mirë në Përfaqësuesen e Kosovës, por edhe në kampionatin elitare të Turqisë, Vedat Muriqi, i ka orët e numëruara në skuadrën e Fenerbahçes, pasi gazeta "Corriere dello Sport" ka raportuar se sulmuesi shtatlartë ka arritur marrëveshje me Lazion, e cila do t'i paguajë skuadrës turke 16 milionë euro dhe dy milionë të tjerë bonuse. Muriqi është paraqitur në 32 ndeshje për Fenerbahçen dhe ka realizuar 15 gola, derisa

interesim për shërbimet e tij kishin shfaqur edhe Manchester United, WBA, Tottenham Hotspur dhe disa klube të tjera. Një tjetër yll i "dardanëve" pritet të bëhet me skuadër të re. Bëhet fjalë për sulmuesin anësor Milot Rashica, i cili do të largohet nga Werder Bremen dhe e ardhmja është mes Gjermanisë dhe Anglisë. Interesim për shërbimet e ish-lojtarit të Vushtrrisë kanë shfaqur shumë klube, por favorite për të nënshkruar janë Aston Villa dhe RB Leipzig. Ndryshe nga këta futbollistë të Kosovës, portieri Samir Ujkani me gjasë do të mbetet pjesë e Torinos edhe për një vit tjetër. Të enjten "Calciomercato" ka raportuar se bisedimet mes portierit nga Vushtrria dhe klubit italian dhe Ujkani pritet të jetë portieri i dytë i skuadrës për edicionin 2020/2021.

SHKURT

Ajeti prezantohet te Celticu

Sulmuesi shqiptar Alban Ajeti edhe zyrtarisht ka nënshkruar me skuadrën e Celticut. Ajeti ka firmosur kontratë katërvjeçare me kampionin e Skocisë, kurse gjiganti scocez ka paguar rreth 5 milionë euro për sulmuesin shqiptar. "Ne jemi të lumtur që kemi sjellë Albanin në Celtic. Është lojtar i jashtëzakonshëm, një reprezentues me kualitetet të vërtetë. E di se është shumë i përkushtuar të bëjë çdo gjë për të sjellë më tepër sukses te tifozët tanë. E kam admiruar për një kohë të gjatë pasi është lojtar shumë inteligjent, me balancë të mirë dhe realizator shumë i mirë. Ne jemi shumë të lumtur që e kemi sjellë atë në Celtic dhe shpresojmë që të ketë karrierë të gjatë dhe të frytshme me ne", ka thënë trajneri i Celticut, Neil Lennon.

Zëvendësministri Grabovci pret në takim përzgjedhësin Shatri

Zëvendësministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Arbër Grabovci, e ka pritur në takim përzgjedhësin e përfaqësueses së Kosovës në basketboll për femra, Fidan Shatri. Temë e diskutimit ishte ndikimi i virusit Korona në sport dhe grumbullimi i përfaqësueses në majin e ardhshëm. "Sot prita në takim selektorin e Përfaqësueses së Kosovës në basketboll në konkurrencën e femrave, Fidan Shatri, me të cilin biseduam rreth situatës momentale në sportin tonë dhe ndikimin e pandemisë së virusit Covid-19 në mbarëvajtjen e aktiviteteve, me theks të veçantë në basketboll. Gjatë takimit folëm rreth organizimit të përfaqësueses 'A' të Kosovës në konkurrencën e femrave, e që pritet në shtator të ketë grumbullimin e parë dhe sfidave që do të ketë formimi i ekipit tonë përfaqësues", ka shkruar Grabovci në profilin e vet në "Facebook".

Haxhaj konfirmon ndarjen me Besën

Futbollisti Adnan Haxhaj ka konfirmuar se me nuk do të jetë pjesë e Besës së Pejës. "Objektivi me Besën u arrit duke e inkuadruar në Superligë aty ku e meriton. Faleminderit të gjithëve që arritëm objektivat e klubit së bashku dhe ju dëshiroj suksese në vazhdim! Kurse unë do t'ju njoftoj shumë shpejt për skuadrën time të re", ka thënë Haxhaj. Ky i fundit më parë ka bartur fanellat e skuadrave si Prishtina, Liria, Drenica, Llapi, Vllaznia e Shkodrës.

Bunjaki: Kosova është favorite për kualifikim në Kampionatin Evropian

Ish-trajneri i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Albert Bunjaki, i sheh 'Dardanët' favorite për një kualifikim në Kampionatin Evropian. Kosova gjendet në gjysmëfinale të "play-off"-it të Ligës së Kombeve dhe është vetëm dy ndeshje larg qëllimit të madh. Në rast fitoreje ndaj Maqedonisë në gjysmëfinale dhe në finale ndaj Gjeorgjisë apo Bjellorusisë, Kosova do ta siguronte për herë të parë pjesëmarrjen në Kampionatin Evropian. E në rrugën drejt kualifikimit, Bunjaki e sheh Kosovën favorite, që para saj ka një mundësi jetike. "Kosova është favorite. Është mundësi jetike që Kosova ta arrijë qëllimin që e ka pasur, të jetë pjesë e Kampionatit Evropian 2020", ka deklaruar Bunjaki për 'Ora Shtatë në Klan Kosova'. Një kualifikim i Kosovës në Euro 2020 do të ishte në vijë me synimet e Bunjakit, që deklaronte se Kosova po përgatitet për kualifikim në Kampionatin Evropian. Kujtojmë se Bunjaki ishte personi që vuri themelet e Kombëtares së Kosovës, duke ofruar lojtarët më cilësorë të saj.

Neymar: Duam ta fitojmë Ligën e Kampionëve

PARIS, 13 GUSHT - Neymari nuk shënoi në ndeshjen çerekfinale të Ligës së Kampionëve kundër Atalantës, por në fund është shpallur lojtari i ndeshjes. Paris Saint-Germain e mposhti në minutat shtesë skuadrën italiane (2-1) dhe u kualifikua në

gjysmëfinale. "Jam i destinuar për këto lloj ndeshjesh shumë të rëndësishme. Është një ndër tri përmbysjet më të mëdha në karrierën time. Jam shumë i lumtur", u shpreh Neymari. "Asnjëherë nuk kam menduar për eliminimin, për shkuarjen në

shtëpi. Që nga minuta e parë të ndodhë çfarë të ndodhë në kokën time ishte se do të kualifikohemi në gjysmëfinale. Askush nuk mund të ma heqë nga koka se do të jemi në finale", ka thënë Neymari. Ylli brazilian është optimist se klubi francez do ta fitojë

Ligën e Kampionëve. "Dëshira është e madhe për ta fituar Ligën e Kampionëve. Na ka mbetur edhe një ndeshje për të arritur në finale, një ndeshje e një niveli tjetër. Do të bëjmë gjithçka për ta fituar në fund trofeun", ka shtuar Neymari.



Munishi: Në sezonin e ri titulli do të varet nga Ballkani

Suharekë, 13 gusht - Trajneri i Ballkanit, Ismet Munishi, në një intervistë për Suhareka Express ka folur rreth afatit kalimtar dhe edicionit të ri futbollistik, ku portokallezintë do të jenë pretendentë për titull.

Çfarë atmosfere po mbizotëron te KF Ballkani?

Munishi: Atmosfera është fantastike me ekipin. Mbizotëron atmosferë e punës, mbizotëron entuziazëm shumë i mirë dhe vullnet shumë i madh nga ana e stafit, lojtarëve, presidentit e të gjithëve.

A do të ketë transferime të reja?

Munishi: Do të ketë transferime në çdo repart ku ne do të shohim e do të sjellim futbollistë cilësorë, është për qëllim që të rritet konkurrenca në klub, nëse e shohim të arsyeshme deri në fund të afatit kalimtar do të ketë transferime me futbollistë shumë cilësorë.

Cilat janë pritjet tuaja për edicionin e ardhshëm?

Munishi: Pritjet e tona për edicionin e ardhshëm do të jenë maksimale.

Kur pritet që Ministria e Shëndetësisë t'ju lejojë që t'i filloni stërvitjet?

Munishi: Nuk e di, por cili do që të jetë vendimi ne do ta respektojmë atë edhe normalisht që presim sa më shpejt që Ministria të vendosë që t'i fillojmë stërvitjet.

Çka nëse Ministria e Shëndetësisë vendos që mos t'i filloni stërvitjet në këtë kohë, a do t'ju penalizojë ky vendim?

Munishi: Nëse Ministria vendos që të mos i fillojmë stërvitjet normalisht që do të na penalizojë shumë.



A i ka Ballkani problem financat?

Munishi: Ballkani nuk i ka problem fondet edhe mund të thëmë që buxheti është shumë më i madh se në vitin e kaluar.

Kur do të kthehet Arbër Hoxha?

Munishi: Arbër Hoxha është duke u rikuperuar shumë mirë, normalisht që ne me padurim e presim rikthimin e tij, mirëpo Arbëri do të na tregojë vetë me punën e tij kur do të jetë i gatshëm. Ne e mirëpresim rikthimin e Arbërit sepse me të vërtetë ka qenë lojtar shumë i rëndësishëm për ne, ndër lojtarët kryesor dhe besoj se ka qenë ndër lojtarët më të mirë në Kosovë.

Cilat ekipe i shihni në garë për t'u shpallur kampion në edicionin e ardhshëm?

Munishi: I gjithë koncentrimi është te skuadra jonë, te Ballkani, skuadrat e tjera absolutisht nuk më interesojnë. Gjithçka do të varet prej neve se kush do të shpallet kampion. Nuk do të varet prej skuadrave të tjera.

A pritni rivalitet më të madh duke pasur parasysh që në edicionin e

ardhshëm Superliga do të paraqitet me 10 skuadra?

Munishi: Rivaliteti me dhjetë skuadra do të jetë i madh dhe normalisht që me këtë rivalitet prej dhjetë skuadrave, ne i kemi përparësitë e tona duke marrë parasysh sezonin e kaluar që ka pasur më pak rivalitet. Çdo rivalitet shtesë për skuadrën e Ballkanit është i mirëseardhur.

Çka u premtori Munishi tifozëve të Ballkanit për edicionin e ardhshëm?

Munishi: Edicionin e ardhshëm normalisht që jo vetëm unë, por që prej presidentit, stafit të futbollistëve dhe të gjithë ne që jemi të angazhuar në klub, premtojmë trofe.

Më 12 shtator 'Xhebrailave' festojnë 28-vjetorin e themelimit si tifogrup.

Munishi: "Xhebrailave" ua uroj përzemërsisht përvjetorin e 28-të! U dëshiroj shumë suksese si tifogrup, sepse janë pasuri në tifozllëkun shqiptar. Shumë herë kanë dhënë mesazhe. Normalisht që ne si klub kemi pasur përkrahje të jashtëzakonshme prej tyre.

Houstoni dështon ndaj Indianas

ORLANDO, 13 GUSHT - U zhvilluan katër sfidat e radhës në NBA, kur kanë mbetur edhe tri raundet e fundit deri në përfundimin e sezonit të rregullt. Houston Rocketsi nuk ia doli të merrte fitoren përballë Indiana Pacersit, përtej shifrave të frikshme të "yllit" të teksanëve, James Harden, i cili e mbylli takimin thuajse me "tripe double": 45 pikë, 17 rikuperime dhe 9 asistime. U mbyll 104-108 në favor të skuadrës nga Indianapolisi, edhe pse kjo e fundit kishte tri mungesa në formacionin nisës: Malcom Brogdon, TJ Warren dhe Domantas Sabonis. Me këtë disfatë, Rockets humbi mundësinë për të arritur në vendin e tretë në Perëndim. Trepikëshi i shënuar nga Muscala, pesë sekonda para rënies



së sirenës, u dhuroi fitoren 116-115 Oklahoma City Thunderit ndaj Miami Heat. Skuadra kaliforniane, edhe pse la shumë hapësira në linjat e dyta, iu afrua shumë suksesit falë 30 pikëve të Tyler Herro. Gjithsesi, në fund morën më shumë vlerë 21 pikë dhe 9 "rebounde" të Bazleyt. Siguroi fitoren e tretë radhazi Toronto Raptors, që iu imponua 125-121 Philadelphia 76ers, me 6

basketbollistë të skuadrës kanadeze me numër dyshifror pikësh. Spikati Chriss Boucher me 19 pikë dhe 9 "rebounde", duke qenë i saktë në 4 nga 6 tentativat për tri pikë. Shënuesi më i mirë rezultoi Harris i 76ers me 22 pikë, por që nuk mjaftuan për ta shmangur humbjen. Los Angeles Clippersi dominoi 124-111 ndaj Denver Nuggetsit falë përmbysjes që erdhi në periodën e fundit, kur skuadra nga Colorado luajti me rezervat, duke lënë të kuptohej se dëshironte vetë ta humbiste takimin. Tashmë Clippers e ka të sigurt përballjen me Dallas Mavericksin të Luka Donçiqit në raundin e parë të fazës "play-off". Në këtë sfidë spikatën Paul George e Kawhi Leonard me 27 dhe 2 pikë.

SHKURT

Juve ia ofron Ronaldon Barcelonës

Cristiano Ronaldo i është ofruar Barcelonës, teksa Juventus kërkon t'i ulë sa më shumë shpenzimet nga paga e futbollistëve. Kampionët e Italisë janë goditur rëndë financiarisht nga pandemia Covid-19 dhe po synojnë ta eliminojnë kontratën milionere të Ronaldos. Madje mësohet se drejtuesit bardhezinj kanë kontaktuar me Barcelonën për ta ditur interesin e saj, sipas gazetarit spanjoll Guillem Balague. Kujtojmë se ylli portugez ishte golashënuesi më i mirë i Joves gjatë sezonit të fundit, me 35 gola në të gjitha garat. Emri i tij u laka edhe te PSG-ja, ndërsa tani lidhet me "Camp Nou". Nëse do të bashkohej me Leo Messin, edhe pse duket një variant i pabesueshëm, do të kishim plot 11 "Topa të Artë" te Barcelona.

Perezi shërohet nga Covid-19, rikthehet në garat e Formula 1

Piloti meksikan Sergio Perez, që garon në Formula 1 me makinën Racing Point, do të rikthehet këtë fundjavë në pistën spanjolle të Montmelo, pas një mungese 2-javore. Ai nuk mori pjesë në dy garat e fundit të zhvilluara në pistën britanike të Silverstone, pasi doli pozitiv me Covid-19. Gjithsesi, kjo periudhë i përket së shkuarës, pasi dy testet e fundit të zhvilluara në harkun kohor të 48 orëve kanë qenë negative. Për pasojë, Perez mund të rikthehet në pistë dhe sot ka marrë OK-in e Federatës Ndërkombëtare të Automobilizmit (FIA) për të garuar. "Pata vetëm simptoma të lehta, ndaj pata mundësi të stërvitem, për të qenë gati për garën e radhës, në Spanjë. Ishte e vështirë t'i shihje garat nga shtëpia, i izoluar, në karantinë", ka thënë Perez. Vendin e tij në dy garat që mungoi e zuri Niko Hulkenberg, që do të dalë sërish rezervë.

Vertonghen, lojtar i Benficas

Jan Vertonghen do të jetë një lojtar i Benficas. Mbrojtësi belg karrierën do ta vazhdojë në elitën e futbollit portugez. Gazetari i njohur dhe eksperti i merkatos, Fabrizio Romano, raporton se një marrëveshje mes Benficas dhe Jan Vertonghen është arritur. Vertonghen do të nënshkruajë kontratë trevjeçare me Benficën. 33-vjeçari belg në tetë sezonet e fundit ka qenë pjesë e Tottenhamit, për të cilën skuadër është paraqitur në 232 ndeshje.

Gjashtë lojtarë të infektuar me Bilbaon

Athletic Bilbao është klubi i radhës që tronditet nga koronavirusi. Plot gjashtë raste pozitive janë regjistruar te basketi, që kanë konfirmuar lajmin e keq me anë të një komunikatë në "Twitter". Personat e prekur janë izoluar menjëherë dhe kanë nisur karantinën në shtëpitë përkatëse. Athletic njoftoi autoritetet shëndetësore, ndërsa të prekurit do t'u nënshtrohen testeve të radhës javën e ardhshme. Në përputhje me udhëzimet që ka dhënë La Liga, seancat stërvitore të ekipit spanjoll që do të nisnin ditën e enjte, do të zhvillohen individuale.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Pllana", SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me pronar Naim Pllana, NRB:7129599, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Pllana" D.O.O. donelo odluku o prestani rada Naim Pllana sa bisnisom: 7129599,, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Pllana" L.L.C. has come to the decision to quit its Naim Pllana business: 7129599, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Renedental", L.L.C. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. UNIK: 810851081, NRB: 71187934 nr. Fis: 601294698 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Renedental" L.L.C. donelo odluku o prestani rada sa nr. UNIK: 810851081, NRB: 71187934 nr. Fis: 601294698, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Renedental" L.L.C. has come to the decision to quit its nr. UNIK: 810851081, NRB: 71187934 nr. Fis: 601294698 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

► Çlirim Musa shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Medreseja "Alauddin" Prishtinë.

► Albana Ballazhi Qerimi shpalle te pavlefshme diplomën e Sh.M.L "Dardania" Hani Elezit.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Haxha Company" Sh.p.k Llaushë, Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të asfaltit në Gojbulë, Vushtrri.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 09.09.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "VILLAGE" në Gojbulë, Vushtrri do të organizohet debat publik nga kompania "Haxha Company" Sh.p.k Llaushë, Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të asfaltit në Gojbulë, Vushtrri.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM
<https://us04web.zoom.us/j/7657246484?pwd=MC9Fbng1Z0Z2dFJjY3haRGY2VH13UT09>

Personal Meeting ID: 765 724 6484
 Passcode: bZ9GS3

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "River Fish" Sh.p.k Gojbulë, Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për akuakulturë-bazën e kultivimit të peshkut në Gojbulë, Vushtrri.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 09.09.2020 në ora 10:00 në hapësirat e restorant "Village Restaurant Fauna" në Gojbulë, Vushtrri do të organizohet debat publik nga kompania "River Fish" Sh.p.k Gojbulë, Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për akuakulturë-bazën e kultivimit të peshkut në Gojbulë, Vushtrri.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM
<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=NjkzeHFBUzJGZEc4dXUzeGx2NXVtZz09>

Meeting ID: 454 934 4495
 Passcode: 1YsD3f

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/giejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
 Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
 Sallon Depilimi Lume's Details
 lumesdetails
 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

